



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
“Kimi dhe Teknologji Ushqimore” i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Magdalena Cara
2. Prof. As. Dr. Anila Kopali

Dhjetor/ 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”



Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kimisë Industriale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MA Nr.31, datë 30.12.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr. 638, datë 22.07.2015
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	S’ka
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (viti akademik 21-22)	34 PAE/10 PAK
18	Numri i studentëve: (3 vitet e funit)	(96+91+91)= 278
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, ofrohet nga Departamenti i Kimisë Industriale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ky program i përgjigjet nevojës së tregut duke u përballur me sfidat e kohës jo vetëm në nivel Kombëtar dhe Rajonal por edhe Europian dhe më gjerë. Baza për arritjen e këtij qëllimi është eksperiencia e gjerë shumëvjeçare tashmë si një nga programet më të vjetra të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe UT.

Aktualisht është i vetmi i këtij lloji në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe ka trashëguar eksperiencën dhe dijet e disa prej figurave më të spikatura të Shkencës dhe Teknologjisë Ushqimore në industrinë kryesore të prodhimit të produkteve ushqimore. Programi ofrohet vetëm me kohë të plotë dhe është i organizuar në tre vite studimi. Organizimi është bërë në mënyrë që të arrihet një harmonizim sa më i mirë i leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike duke u fokusuar në ndërthurjen e teorisë me praktikën laboratorike në përputhje me natyrën e formimit profesional që ofron ky program studimi dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi: Ligji Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 41, datë. 24.01.2018 dhe VKM Nr.875, datë 18.12.2019. Në dispozicion të studentëve, si dhe për realizimin me sukses të këtij programi studimi është një infrastrukturë bashkëkohore didaktike duke përfshirë këtu jo vetëm auditorët, por edhe laboratorët mësimorë, bibliotekën, përdorimin e internetit, si dhe të gjitha fasilitetet e tjera që mundësojnë një mësimdhënie cilësore, jo vetëm në ecurinë e zakonshme, edhe në kushtet vështira të pandemisë.

Institucioni bashkepunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit. Kjo mbështetet nga mjaft marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private, si dhe me sektorin e biznesit.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një ekip i FSHN, i cili përfshin anëtarë të stafit akademik si dhe përfaqësues të studentëve. Grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) i mbështet argumentat e shkruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) në një sërë dokumentash të vëna në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përmes sistemit AMS. GVB gjykon se në të pesë fusha e vlerësimit, standartet janë të përmbushura plotësisht.

GVJ përbëhet nga dy profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT). Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm ata janë mbështetur nga një Menaxher i Vlerësimit, përfaqësues i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) e cila mbante gjithashtu dhe shënimet për takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucion. GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe të gjitha evidencat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i programit të studimit.

GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm të autoriteteve drejtuese të FSHN, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik të departamentit dhe të programit të studimit, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambientet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin studimit, vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën, etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet të cilat janë dhënë në fushat përkatëse.

Më datë 22/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/153 Prot., datë 22/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. UT kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 13/12/2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” (KTU) ofrohet nga Departamenti i Kimisë Industriale (DKI), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe është në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, Statutit të UT (Dokumenti I.2) dhe në përputhje me objektivat dhe misionin e UT të shprehura në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 të UT Dokumenti I.3,4,5 dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Me këtë program DKI synon përgatitjen e studentëve të kimisë ushqimore me formim të përgjithshëm tre vjeçar sipas shkresës së MASH Nr. 7897, datë 14.02.2005 (Dokumenti I.1).
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, por dhe nga informacioni i vënë në dispozicion, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se ky program kontribuon në zhvillimin e shoqërisë nëpërmjet kërkimit shkencor dhe edukimit në përputhje me qëllimet dhe misionin e UT si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Në Strategjinë e UT 2018-2023 thuhet që UT e ka në objektiv “Zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimeve afat-mesëm dhe afat-gjatë, të cilët rrisin vlerën kombëtare dhe ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës”. Programi i studimit KTU synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike në fushën e Kimisë dhe Teknologjisë Ushqimore. DKI ka në misionin e tij (Rregullorja e DKI) (Dokumenti I.6) promovimin e njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe vënien e tyre në shërbim të zhvillimit kombëtar dhe rajonal.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	FSHN ka hartuar dhe ofron Programin e Studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” në përputhje me Misionin e UT, e referuar në Statutin e UT-së, si dhe në përputhje me misionin dhe objektivat e Departamentit të Kimisë Industriale (Dokumenti I.6). Nga i gjithë dokumentacioni në dispozicion si dhe intervistat u pa qartë se PS synon përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në fushën e kimisë dhe teknologjisë ushqimore.
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ ose kombëtar.	DKI duke patur parasysh zhvillimet dhe perspektivat ekonomike të vendit ka zbatuar Planin Strategjik të programit të studimit (Dokumenti I.7), në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UT (Dokumenti I.3). Ky program studimi i hartuar me këtë drejtim është një kurrikul në përputhje me kapacitetet e brëndëshme, ekperiencat më

	të mira kombëtare si edhe duke patur parasysh zhvillimet dhe perspektivat ekonomike të vendit, sipas Planit Strategjik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga dokumentacioni në dispozicion konstatohet se: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Kimisë Industriale, harton dhe ofron Programe studimi në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit, sa më sipër janë të përcaktuara qartë në Strategjinë e zhvillimit të UT. Programi i studimit “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” është së pari në përputhje me Planin Strategjik të UT 2018-2023 (Dokumenti nr. I.3), vizionin dhe misionin e UT-së dhe Planin Strategjik për zhvillimin e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” (Dokumenti nr. I.7).			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga dokumentat në dispozicion: Statuti (Dokumenti nr. I.2) dhe rregullorja e UT-së (Dokumenti nr. I.8) përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të UT. Në këto dokumenta demonstron se programet e studimit, duke përfshirë edhe programin Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” hartohen dhe ofrohen bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në Statutin dhe Rregulloren e UT-së. Po kështu edhe Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” synon të përmbushë drejtimit prioritar akademike siç janë rritja e standardeve të cilësisë në funksion të përmirësimeve në programet e studimit në mënyrë që edukimi i studentëve të jetë në funksion të kërkesat e tregut të punës.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Materialet e vëna në dispozicion të GVJ verifikojnë që; emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtij PS është e ofruar në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UT dhe FSHN. Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” siguron Diplomë Universitare Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3				
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto	Nga dokumentacioni në dispozicion shihet qartë se Programi Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” ka objektv të përcaktuara qartë dhe synon pajisjen e studentëve me njohuri të			

<p>programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>përgjithshme dhe specifike në disiplinat kimike dhe teknologjike si: Kimia e Përgjithshme, Kimia Organike, Kimia Fizike dhe Koloidale, Teknologji Ushqimore, Mikrobiologji Ushqimore, Inxhinieria e proceseve kimike, etj. Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” ka përcaktuar qartë objektivat e veta në Misionin e Departamentit të Kimisë Industriale (Dokumenti nr. I.6) të paraqitur në Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale dhe në faqen eeb të FSHN, (https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale).</p> <p>Syllabuset kanë të përcaktuara objektivat dhe aftësitë me të cilat pajiset studenti në përfundim të programit të studimit (Dokumenti nr. I.10).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter janë të dhënat e përfuara në kuadër të akreditimit institucional, (Dokumenti nr. I.11· Dokumenti nr. I.12) ku UT ka realizuar studimin e tregut të punës duke ngritur grupin e punës (Dokumenti nr. I.13). Sic edhe thuhet në RVB: Gjatë këtij studimi (Dokumenti nr. I.14) shihet që 79% e të intervistuarve qëndrojnë në Tiranë meqë ka më shumë mundësi punësimi në profesion. Tendencat e tregut tregojnë që studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë treg të konsiderueshëm pune mbi 50%. 55% punësohen që gjatë kohës që janë studentë (Dokumenti nr. I.14). Sektori privat mbetet më i preferuar (43%) për studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por një përqindje të ndjeshme ka edhe sektori shtetëror 22%. Kjo përqindje qëndron e lartë në të gjithë vitet e diplomimit. (Dokumenti nr. I.14): Nga studimi i tregut i realizuar pranë DKI u vu re se studentët të cilët kanë përfunduar studime te ciklit të parë dhe të dytë (ose janë duke përfunduar ciklin e dytë të studimeve) punësohen në institucione publike ose private (Dokumenti nr. I.15). Nga ky studim rezultoi se 27.1% e të anketuarve janë të punësuar, 10.2% janë në pritje të punësimit dhe 62.7% janë pa punë. Nga të anketuarit e punësuar rezultoi se 18.1% punojnë në sektorin publik dhe 81.8% në sektorin privat. Nga të punësuarit e sektorit publik rezultoi se 13.6% punojnë në administratën shtetërore, 4.5% punojnë në institucion publik të arsimit të lartë. Nga të punësuarit në sektorin privat rezultoi se 4.5 % janë të vetpunësuar (Dokumenti nr. I.15).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues të këtij Programi studimi Bachelor KTU janë të lidhura me: Formimin e specialistëve kimistë dhe teknologëve në fushën e kimisë ushqimore, përgatitja e specialistëve të aftë në analizimin dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve, përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit (syllabuseve) për tu përgjigjur më mirë ndryshimeve dhe tendencave në kërkesat që parashtron zhvillimi ekonomik i vendit dhe më gjerë. Për përbushjen e këtyre objektivave puna e stafit akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Kimisë Industriale është e fokusuar në formimin e studentëve dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi nënjë fushë të caktuar.</p>	<p>Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Dokumenti nr. I.21) që është një prej fakulteteve më të vjetër të tij (që në krijim) ka demonstruar përvojën e tij shumëvjeçare në përgatitjen e brezave të kualifikuar në fushën e biologjisë, fizikës, kimisë dhe matematikës. Në mënyrë sistematike ka përsosur përvojën e tij dhe në ditët e sotme ofron dhe alternativa më të gjera specialistësh si psh. teknolog kimist ushqimor, duke ju përshtatur kërkesave të tregut. Sipërfaqja e totale (në pronësi) e UT dhe fakultetet e tij është 190.597 m², ku godinat zënë një sipërfaqe prej 19.835 m² dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 48888 m², (Dokumenti I.3). Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet prej 8 departamentesh dhe 1 qendër kërkimore (Dokumenti I.23). Ai e zhvillon veprimtarinë mësimore-kërkimore në kater Godinat A, B, C dhe D (Dokumenti I.16). Në përputhje me legjislacionin në fuqi departamentet e FSHN-së kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-biologjiise, https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-bioteknologjiise,. Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” ofrohet nga një staf i kualifikuar (Dokumenti nr. I.24), të cilët kanë eksperiencën e duhur për të mbuluar lëndët e programit të studimit. Aktualisht në Departamentin e Kimisë Industriale stafi akademik me kohë të plotë përbëhet nga 19 pedagogë të kategorisë lektor me tituj dhe grada shkencore: nga të cilët 3 (tre) mbajnë titullin akademik “Profesor”; 4 (katër) mbajnë titullin “Prof Asoc”; dhe 10 (dhjetë) kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”; 2 (dy) asistentë lektorë kanë gradën MSc, (këta anëtarë të stafit PAE janë të rinj, që nuk kanë filluar procesin e kualifikimit të marjes së gradave shkencore pasi pritet hapja e studimeve të Ciklit të Tretë pranë IAL) (Dokumenti nr. I.27).</p> <p>Për rritjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor Kimi dhe Teknologji Ushqimore, dhe për ofrimin e përvojave më të mira të kërkimit dhe mësimdhënies, DKI ka bërë pjesë të tij vazhdimisht si staf akademik të ftuar¹, profesorë dhe lektorë të spikatur (Dokumenti nr. I.28).</p>

	<p>Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe evidencat mbështetëse, rezulton që Departamenti i Kimisë Industriale ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga dokumentacioni vërehet që: fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Dokumenti nr.I.2) i cili mbulon fushën e Shkencave Natyrore.</p> <p>Nga CV e stafit akademik si edhe nga kurrikula e PS dhe syllabuset përkatëse vihet re që: fusha akademike kërkimore dhe shkencore e stafit akademik mësimdhënës në këtë program studimi (Dokumenti nr. I.25) është konform me disiplinat e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”.</p> <p>Programi është i organizuar në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentët përbërës të tij dhe të respektohet legjislacioni në fuqi (Ligji Nr. 80/2015) lidhur me strukturën e programit të studimit, shpërndarjen e krediteve (Dokumenti nr. I.9) sigurimin e cilësisë sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare (VKM- Nr. 875 datë 18.12.2019, (Dokumenti nr. I.29) dhe evropiane (Dokumenti nr. I.30).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter theksojmë që: Në Ligjin e Arsimit të Lartë (Ligji Nr. 80/2015), thuhet se “<i>Departamenti si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, përfshin fusha kërkimi të përafërta si dhe nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, në varësi të llojit të institucionit</i>”. Sa më sipër DKI ofron Programin e studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, i cili mbulon sipas manualit të Frascatit fushën e “Shkencat Natyrore” (https://ëëë.oecd.org/sti/frascati-manual-2015-9789264239012-en.htm), dhe është program i nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Ligji Nr.23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën Shqiptare të kualifikimeve” fq. 7).</p> <p>Në RVB thuhet që: Veprimtaria formuese e programit të studimit “Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore”² organizohet në veprimtari të formimit bazë, veprimtari karakterizuese, disiplina ndërdisiplinore/ integruese (nëndisiplina dhe lëndë profili me zgjedhje), veprimtari plotësuese (për njohjen e gjuhës së huaj, informatike) dhe detyrime përmbyllëse (provim formimi), në respektim të shpërndarjes në përqindje të secilit grup të disiplinave të formimit dhe i përcaktimit të krediteve.</p> <p>Element kodifikimi është fusha e studimit, e cila mund të përfshijë programe studimi të ngjashme, të cilat duhet të plotësojnë kushtin e ngjashmërisë (ndarja e krediteve të detyruara) deri në nivelin 70%.</p>

	Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” (Dokumenti nr. I.9), (Dokumenti nr. I.16) që ofron DKI plotëson kushtin e ngjashmërisë. Kjo lejon transferimin e studentëve (Dokumenti nr. I.31) nga një institucion në tjetrin pa krijuar probleme ekuivalentim lëndësh për studentët. Kohëzgjatja normale e studimeve për diplomimin në “Bachelor” është 3 vjet dhe studentët diplomohen kur kanë fituar 180 kredite (Dokumenti nr. I.2 Statuti i UT, Neni 89, fq. 56). Në përfundim studentëve u lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion vihet re se në Statutin dhe Rregulloren e UT-së, është dhënë e qartë ndarja e detyrave mes njësisve e personelit, marrja e përgjegjësisve respektive dhe analizës të punës së tyre. Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së UT-së dhe synojnë mbarëvajtjen e programit të studimit. Veprimtaria e UT-së organizohet dhe realizohet nëpërmjet njësisve akademike, ndihmës-akademike dhe administrative të shtrira në njësitë kryesore dhe strukturën e rektoratit (Dokumenti nr. I.2) .</p> <p>Dekanati i FSHN bashkërendon oraret mësimor (Dokumenti nr. I.32) dhe komunikimin midis njësisve bazë të FSHN për lëndët e programit të studimit që ofrohen nga departamentet e tjera si: Fizika, Matematika, Kimia, Informatika etj. Dekanati miraton paraprakisht propozimet e njësisë bazë për kuotat (Dokumenti nr. I.33) kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit (Dokumenti nr. I.34) dhe çdo propozim tjetër, dhe i përcjell ato në Senatit Akademik për miratim përfundimtar.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit para nisjes të çdo viti akademik njofton dhe kërkon përditësimin e syllabuseve nga stafi akademik (Dokumenti nr. I.36).</p> <p>Në DKI funksionojnë grupe pune <i>ad hoc</i> të ngritura nga Përgjegjësi i departamenti për një sërë procedurash si transferimi (Dokumenti nr. I.2 Statuti i UT, Neni 109, fq. 64), (Dokumenti I.37 Komisionet e shqyrtimit të dosjeve Dege e II & Transferimet), punësimi stafi akademik dhe ndihmës akademik (Dokumenti nr. I.38 dhe nr. I.39), përpilim i kërkesave buxhetore (Dokumenti nr. I.40), komisioni i provimit të diplomës (Dokumenti nr. I.41), etj.</p>

	Dekani miraton çdo vit akademik komisionet “Ad-hoc” të propozuara nga departamentet/ njësitë bazë për shqyrtimin e transferimeve dhe degëve të dyta (Dokument nr. I.37).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Nga dokumentacioni në dispozicion shihet që: UT ka nënshkruar 42 marrëveshje me 100 universitete homologe jashtë vendit (https://unitir.edu.al/arkiva-marreveshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/) gjatë periudhës 2019-2023 në kuadër të programit Erasmus+KA107. Sa më sipër janë të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës (https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/). Disa anëtarë të Departamentit të Kimisë Industriale (Dokument nr. 1.28) janë angazhuar pranë njësisë Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë Shqiptare (Nanoalb) (http://ëëë.nanoalb.al/nanoalb/about.php) e krijuar në vitin 2019 në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave. Nga takimi me studentët u pa se ata kanë interes për trajnime ose internship Departamenti i Kimisë Industriale (Dokument nr.1.28) e pasqyruar kjo edhe tek, kjo realizohet nëpërmjet Dekanatit të FSHN (Dokument nr. 1.33) duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës që mbulon Departamenti i Kimisë Industriale si p.sh Kantina e Pijeve “Gjergj Kastrioti”, Lufra, Integrated Energy (Zona e Trajtimt të Mbetjeve, Sharrë), Fabrika Stela, etj.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga takimi me stafin e Departamentit të Kimisë Industriale (DKI) dhe nga dokumentacioni në dispozicioni u vërejt se me njoftim nga Përgjegjësi i Departamentit (Dokument nr. 1.34) dhe (Dokument nr.1.28) përgatiten raportet vjetore mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të cilat janë pjesë e integruar e raportit të analizës vjetore të DKI (Dokument nr. 3.12), ato janë objekt i diskutimeve në mbledhje të departamentit, dhe konsistojnë në vlerësimin e mobiliteteve të stafit akademik dalës dhe hyrës, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik, dhe nxitjen e mobiliteteve të stafit dhe studenteve. Vetë stafi pohon se marrëveshjet e bashkëpunimit kanë kontribuar në fitimin e eksperiencës në mësimdhënie nga ana e personelit akademik dhe në bashkëpunim për kërkimin shkencor.
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<i>Një nga mangësitë themelore që u vu re në PS Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” ishte se praktikën e detyruar profesionale nuk e ka pjesë të kurrikulës së vet.</i> Fakulteti dhe Universiteti kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikave mësimore në Programet e Ciklit të Dytë të studimit (Dokument nr. 1.28) dhe (Dokument nr. 1.33) sipas evidencave të deklaruara por kjo nuk është pjesë e PS. Një e metë që duhet të konsiderohet sa më parë që të jetë e mundur.
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga takimet me stafin akademik dhe studentët departamentit u evidentua organizimi i disa seminareve dhe trajnimeve profesionale e lidhur kjo edhe me lektorët e ftuar në kuadër të FSHN ose departamentit. Në organizimet e mësipërme krahas pedagogëve ku ftohën të marrin pjesë edhe studentët të PS (Evidencë nr. 1.35).

	<p>Vetë stafi pohon interesin e shtuar për organizimin e orëve të hapura me lektorë të ftuar të cilët mbajnë jo vetëm leksione por edhe bashkëbisedime mbi tema të ndryshme në interes të formimit të backgroundit profesional të studentëve si specialistë të ardhshëm (Evidencë 1.36).</p> <p>Projekti Erasmus+ NETCHEM (https://fshn.edu.al/notifications/net-chem-ict-netëorking-for-overcoming-technical-and-social-barriers-in-instrumental-analytical-chemistry-education-2019), (Dokumenti nr. 1.31) gjatë 3 viteve ka realizuar disa ëorkshop-e me pjesëmarrjen edhe të studentëve. Nga bashkëpunimi me Njësinë Nanoalb pranë Akademisë së Shkencave u realizua ëorkshop i parë i Nanoalb me pjesëmarrjen edhe të studentëve (Dokumenti nr. 1.38).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi: me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimin Nr.15 datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” (Udhëzimi Nr. 15), si edhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (Dokumenti nr. I.2), programi i studimit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” është i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite. Sipas dokumentacionit në dipozicion si edhe RVB vërehet që: numri total i krediteve për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore është 180 ECTS. Plani mësimor realizohet në 3 vite studimi ose në 6 semestra (Dokumenti nr. 1.9) dhe (Dokumenti nr. I.20), me 30 kredite çdo semestër. Sasia maksimale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Gjithë programi ka 180 ECTS në total ku 1 kredit është ekuivalent me 25 orë mësimore në auditor dhe studim individual (Dokumenti nr. I.9). Programet e studimeve hartohen nga njesitë bazë të UT dhe miratohen në Senatin Akademik (Dokumenti nr.1.8) dhe (Dokumenti nr. 1.20, Rregullore e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, Neni 8, fq. 6).</p> <p>Kreditet e lëndëve paraqiten në syllabuset përkatëse për secilën lëndë sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 dhe janë pasqyruar edhe në kurrikulën dhe planin mësimor të çdo viti mësimor akademik (Dokumenti nr. I.9).</p> <p>Lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese:</p> <p>Lëndë të përgjithshme; lëndë bazë dhe përgatitje metodologjike – tipologjia (A);</p> <p>Lëndë karakterizuese, përgatitje për disiplinën shkencore – tipologjia (B)</p> <p>Lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe grup -lëndë me zgjedhje – tipologjia (C).</p> <p>Lëndë/ module plotësuese: gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktikë etj - tipologjia (D)</p> <p>Detyrime përmbyllëse - provimi i formimit, tipologjia (E);</p> <p>Lëndët e kategorisë A + B jo më pak se 70 % të numrit të përgjithshëm të krediteve.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Nga dokumentacioni i PS në ciklin e parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore vihet re që ai synon përgatitjen e specialistëve të lartë me formim kimist - teknologë ushqimorë dhe inxhinierë kimistë ushqimorë, me kompetenca profesionale në fushën e teknologjisë ushqimore.</p> <p>Cikli e parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore përgatit studentë me dije dhe kopetenca në fushën e analizave kimiko-fizike</p>

	<p>dhe mikrobiologjike të ushqimeve, si specialistë për arritjen e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Ata janë të aftë të kontribuojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor duke filluar: me transformimin e lëndëve të para me origjinë bimore, shtazore nëpërmjet teknologjive të përpunimit, bioteknologjisë të fermentimeve, me ruajtjen dhe tregtimin e sigurtë të produkteve ushqimore (Dokumenti nr. I.20).</p> <p>Gjithashtu, në kuadrin e formimit të përgjithshme dhe karakterizues përfshihen njohuri të përgjithshme nga: Matematika, Fizika, Kimia e Përgjithshme e Inorganike, Kimia Organike, Kimia Fizike dhe Koloidale, Kimia Analitike, etj. Njohuritë e marra gjatë këtij programi mësimor së bashku me lëndët e profilit: Kimia dhe Teknologjia Ushqimore I dhe II, Mikrobiologjia Ushqimore I dhe II, Bazat e Enzimologjisë, Procese dhe Impiante në Inxhinierinë Kimike, Bazat e Transportit të Impulsit, Nxehësisë dhe Masës, Kontrolli i proceseve në Inxhinierinë kimike, Inxhineria e Reaksioneve Kimike, ndihmojnë studentin për formimin e tij të mëtejshëm si një inxhinier kimist ushqimor (Dokumenti nr.I.9).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, jep njohuri të përparuara në fushën e studimit që ai mbulon: Kimi dhe teknologji ushqimore si edhe konceptet për të qenë sa më të pranueshëm për punësim. Aty përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Gjithashtu studentëve ju ofrohen edhe njohuritë bazë mbi metoda dhe parime të përgjithëshme shkencore që janë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera në vazhdimësi të studimit.</p> <p>Një nga veprimtaritë formuese akademike të programit, që i mundëson studentit të përvetësojë dhe të provojë aftësitë e tij kërkimore-mësimore janë seancat laboratorike (Dokumenti nr. II.1). Nëpërmjet seancave laboratorike studenti fiton aftësi e shprehi praktike, prandaj orët laboratorike zënë një peshë të konsiderueshme në programin mësimor të studimit Bachelor në KTU.</p> <p>Departamenti ka në dispozicion një numër të konsiderueshëm laboratoresh (Dokumenti nr. I.16).</p> <p>Nga dokumentacioni në dispozicion, takimi me stafin akademik të departamentit dhe programit të studimit, si edhe me studentët e PS u vu re që: Programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” nuk e ka përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare. Stafi sqaron se: për studentët që kanë interes për eksperiencë praktike në prodhim, Departamenti i Kimisë Industriale/ FSHN ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore dhe kompani private, që janë dhe një mundësi e mirë për realizimin e intershipeve dhe mundësi punësimi për ta (Dokumenti nr. 1.42), (Dokumenti I.16).</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, synon të zhvillojë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e kimisë dhe teknologjisë ushqimore. Sa më sipër pohohet nga stafi akademik i programit të studimit që ata kanë lidhje me ndërmarrje private të specializuara dhe profesionale në fushën e</p>

<p>zgjdhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>teknologjisë ushqimore me qëllim që ky program studimi të jetë sa më profesional dhe sa më afër kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, nga stafi akademik pohohet se zhvillimi i kompetencave profesionale sigurohet edhe duke u mbështetur në literaturën bashkohore të përditësuar vazhdimisht, e cila gjendet hard copy në departament dhe online (Dokumenti nr. II.3).</p> <p>Programi i studimit siguron dhënien e njohurive, aftësi dhe kompetenca të karakterit specifik lidhur me: përpunimin e produkteve ushqimore, teknologji të transformimit/ ruajtjes dhe sistemin e manaxhimit të cilësisë së ushqimit. Në përfundim të programit të studimit, studentët zotërojnë kompetenca dhe kapacitete analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e industrisë ushqimore.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe duke cituar RVB vërehet që elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore Programi i studimit: Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore përmban të gjitha elementet e strukturës së kërkuar prej Udhëzimit Nr.41 të MASR, dt. 24.01.2018 për “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”.</p> <p>Dosja e plotë (Dokumenti nr. II.4) e programit të studimit Bachelor në KTU përmban: Organizimin e Programit të Studimit, Personelin Akademik në funksion të Programit të studimit (Dokumenti nr. I.16), Planin Mësimor (Dokumenti nr. I.9), Programet e lëndëve/ Syllabuset (Dokumenti I.10), Rregulloren e programit të studimit (Dokumenti I.20), Modeli i Diplomës (Dokumenti nr. II.5), Suplementi i Diplomës (Dokumenti nr. II.6), Personelin ndihmes akademik në funksion të Programit të studimit (Dokumenti nr. I.16), Dosja e CV te Personelit Akademik për programin KTU (Dokumenti nr. II.7) CV për personelin ndihmës akademik (Dokumenti nr.I.26).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore ka dokument thelbësor planin mësimor i cili ka karakter informativ, ku jepen në mënyrë të përmbledhur tërësia e veprimtarive formuese dhe është konform akteve ligjore e nënligjore për IAL (VKM- Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”), (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 33, fq.22).</p> <p>Plani mësimor tregon: emërtimin e programit të studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, tërësinë e veprimtarive formuese (disiplinave ose moduleve), kurrikula, me tipologjitë përkatëse, kreditet për çdo veprimtari formuese, lëndë ose modul, shpërndarja e orëve brenda një disipline, sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte).</p> <p>Në planin mësimor, pasqyrohet raporti teori-praktikë për disipinat mësimore, detyrimet mësimore për çdo disiplinë, (VLV ose provim), gjithashtu plani mësimor tregon ngarkesën javore në auditor (Dokumenti nr.II.4). Ngarkesa javore e studentëve në auditor për çdo semester të planit mësimor për këtë program studimi është më pak se 25 orë. Konkretisht në vitin e parë ngarkesa është 20,5 orë/javë në</p>

	<p>semestrin e parë dhe 22 orë/javë në semestrin e dytë (Dokumenti nr. I.16). Ngarkesa më e lartë javore për këtë program studimi është në semestrin e dytë, viti tretë (semestri 6) me 23,5 orë/javë në auditor (Dokumenti nr. I.16). Bazuar në planet mësimore programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore zhvillohet në 6 semestra, ka 180 kredite gjithësej, ka 30 disiplina formuese, nga të cilat një është detyrim përmbyllës – provim formimi. Ky program studimi ka lëndë të karakterit të detyrueshëm dhe me zgjedhje (Dokumenti nr. I.8). Për modulet me zgjedhje, studenti duhet të zgjedhë nga një grup lëndësh prej 6 module gjithësej, 3 prej tyre me zgjedhje, gjatë tre viteve të studimit. Këto 3 lëndë me zgjedhje në total kanë 8 kredite (Dokumenti II.4, Dokumenti I.16).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion dhe duke cituar RVB vërehet sa PS Bachelor KTU ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. (VKM- Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” Pika 2.5 fq.5), (Dokumenti nr. I.8).</p> <p>Tipi ose tipologjia e veprimtarive formuese është nga (A-F) sipas VKM nr 41/2018, dhe shtojcës së saj.</p> <p>Lëndët janë të ndara sipas kategorive të mëposhtme:</p> <p>A. Lëndë bazë: Disiplina e formimit të përgjithshëm, tipologjia A duhet të kenë (15% - 20% të krediteve totale);</p> <p>B. Lëndë karakterizuese: Disiplina të formimit karakterizues të programit, tipologjia B duhet të kenë (50% - 55% të krediteve totale);</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe grup-lëndë me zgjedhje – tipologjia C (12% -15% të krediteve totale);</p> <p>D. Lëndë plotësuese: Lëndë/module plotësuese: gjuhë të huaja, njohuri informatike, edukim fizik, tipologjia D (10-15% kredite);</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse - provimi i formimit final, tipologjia (E); (3%-5% kredite) (VKM- Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” Shtojca Nr. 1, Tabela nr.1).</p> <p>Bazuar në dokumentat më sipër programi i studimit Bachelor në KTU ka gjithësej 30 lëndë/module të cilat tregohen tek kurrikulat ose planet mësimore. Programi i studimit Bachelor në KTU ka:</p> <p>7 module/ lëndë bazë (tipologjia A) me 53 ECTS ose 29% të krediteve totale që zhvillohen në vitin e parë dhe të dytë;</p> <p>13 module/ lëndë karakterizuese (tipologjia B) me 90 ECTS ose 50% të krediteve totale;</p> <p>6 module lëndë integruese - formuese (tipologjia C) me 24 ECTS ose 13% të krediteve totale, këtu futen dhe module të lëndëve me zgjedhje.</p> <p>3 module lëndë të plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, edukim fizik), të tipologjisë D me 9 kredite që përbëjnë 5% të krediteve totale.</p> <p>1 detyrim përmbyllës (tipologjia E) –provim diplome me 4 ECTS ose rreth 3% të krediteve totale.</p>

	<p>Të gjitha lëndët në total janë 180 ECTS ose 100% (Dokumenti nr. I.16) Përqindja e lëndëve të kategorive A + B në programin e studimit Bachelor në KTU rezulton 79%. (në përputhje me kriterin që: lëndët e kategorisë A + B duhet të jenë jo më pak se 70 % të numrit të përgjithshëm të krediteve.).</p> <p>Në përputhje me VKM Nr. 41 është kategoria B dhe kategoria C. Siç u diskutua edhe në takimin tomë me grupin e GVB, është ngritur nje grup pune dhe është propozuar një draft i Planit Mesimor të Programit Bachelor KTU ku merren në konsideratë rishikimi për kategorinë e lëndëve bazë A me synimin ulje të krediteve të tyre deri në % e lejuar dhe nje rritje të përqindjes për kategorinë D - lëndë plotësuese. Në takimin me personelin akademik të PS u diskutua fakti që: tek kategoria D ka një problem, pasi për arsye të specifikave të programit lëndët plotësuese janë të përcaktuara (kufizuara) prandaj synohet një rritje kreditesh në informatikë dhe në fiskulturë si edhe një mundësi për shtimin e një lënde plotësuese të re. Gjithashtu në kategorinë E synohet shtimi i praktikave me kredite duke ndryshuar dhe rritur % mbi 2.2 deri ne 3% (pasi deri tani praktikat në Programin Bachelor kanë qenë individuale dhe janë realizuar spontanisht në kompanitë ku studentët kanë patur interes. Realizimi është bërë me marrëveshje dypalëshe Fakultet - Kompani dhe përgjithësisht kohëzgjatja ka qenë nga 2 javë deri në tre muaj). Sa më sipër u dakortësua me personelin e PS që: Të gjitha keto ndryshime do të mundësohen si ndryshime vjetore me kërkesë ndryshimesh deri në 20% të programit mesimor që aprovohet nga Rektori i UT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Shtet përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion vërehet që: Univesiteti i Tiranës është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.84 datë 27.10.2018 (Dokumenti nr. 1.12), (Dokumenti nr. I.11). UT ka marrë konfirmimin nga ASCAL për akreditimin e Programit të Studimit në ciklin e parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore (Dokumenti nr. II.9).</p> <p>Bazuar në Statutin e Universiteti të Tiranës (Dokumenti nr. I.2, Statuti i UT, Kreu II, Neni 14, Pika 5, fq.9-10) njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore është Departamenti i Kimisë Industriale (DKI), i cili është përgjegjës për programet e studimit që ofron vetë; gjithësej 5 programe studimi. Departamenti është përgjegjës për programet ndërdisiplinore të studimit, për lëndët përkatëse të programeve të studimit që mbulohen nga departamente të tjera brenda/ jashtë njësisë kryesore FSHN (Dokumenti nr. I.16). Departamenti Kimi Industriale ka hartuar</p>

	<p>përbajtjen e programeve të studimit dhe kujdeset për ecurinë e tyre, riorganizim dhe përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës. DKI ka vendimarrjen që lidhet me kurrikulat e programeve të gjithë cikleve të ofruara nga vetë ai, si dhe fushat e kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Koordinatori i PS Kimi dhe Teknologji Ushqimore është Përgjegjësi i departamentit (Dokumenti nr. I.20). Nga takimi me koordinatorin e programit, ai pohon se harton një raport mbi ecurinë e programit të studimit ku janë të specifikuar të gjitha ecuritë dhe problematikat e shfaqura gjatë vitit që reflektohen edhe në analizat vjetore të njësisë kryesore – FSHN (Dokumenti nr.I.48).</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Përgjegjësi i Departamentit drejton punën për hartimin e kurrikulave për të gjitha ciklet e studimeve që mbulon departamenti dhe të planeve mësimore përkatëse dhe ndjek zbatimin e tyre (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit Tiranës, Kreu II, Neni 23, pika 1, fq.15).</p> <p>Përgjegjësi i departamentit mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar; kryerjen të kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit Tiranës, Kreu II, Neni 23, pika 3, fq. 15).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore /bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FSHN/DKI përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike të PS. Sipas dokumentacionit dhe RVB: Departamenti i Kimisë Industriale plotëson standardin numerik (mbi 7 personel akademik efektive, PAE) për të qenë njësi bazë, pasi ka në përbërje të tij aktualisht 19 anëtarë të kategorisë PAE (me kohë të plotë) nga të cilët 17 të kategorisë lektor janë me tituj dhe grada shkencore, vetëm 2 pjëstarë të PAE janë asistent lektorë (Dokumenti nr. I.16). Përveç Përgjegjësit të Departamentit/ Koordinator i programeve të studimit, në DKI funksionojnë edhe Përgjegjësit e Grupeve mësimore kërkimore (Dokumenti I.2 Statuti i Universitetit Tiranës, Neni 19, Pikat 1-3, fq.12 dhe Neni 74, Pika 6, fq.47).</p> <p>Përgjegjësi i grupit mësimor dhe kërkimor (Përgjegjësi/ Titullari i Grup- Lëndëve në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit/ Koordinatorin; ndër të tjera mbikqyr/ monitoron respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera. Ndjek aktivitetin mësimor dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmës-akademik të grupit dhe raporton tek Përgjegjësi i Departamentit realizimin e programit mësimor dhe kërkimor (Dokumenti I.8 Rregullore e Universitetit Tiranës, Kreu II, Neni 24, fq.16). Departamenti i Kimisë Industriale ka në përbërjen e tij 3 grupe mësimore kërkimore (Dokumenti II.11): Grupi mësimor kërkimor Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Grupi mësimor kërkimor Teknologji Kimike, Grupi mësimor kërkimor Inxhinieria e Proceseve Kimike. Fakulteti i Shkencave të Natyrës u ofron studentëve Kujdestarin Akademik (Dokumenti nr. I.2 Statuti i Universitetit Tiranës, Kreu IX, Neni 127, fq. 70) të tyre, i cili raporton mbi problemt e studentëve tek Përgjegjësi i Departamentit.</p>

<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Dokumentacioni vërteton që DKI përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. DKI përbëhet nga 19 pjesëtar gjithësej, nga të cilët 17 personel të kategorisë lektorë janë me tituj dhe grada shkencore: 3 (tre) mbajnë titullin akademik “Profesor”, 4 (katër) mbajnë titullin “Prof Asoc”; dhe 10 (dhjetë) kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”; 2 pjestarë të stafit janë asistentë lektorë dhe kanë gradën MSc. Këta anëtarë të stafit PAE janë të rinj, që nuk kanë filluar procesin e kualifikimit të marjes së gradave shkencore pasi pritej hapja e studimeve të Ciklit të Tretë të Doktoraturës pranë IAL (Dokumenti I.25) (pohohet se ata kanë aplikuar tashmë për tu regjistruar në studimet e ciklit të tretë).</p> <p>Stafi mbështetës ndihmës akademik dhe administrativ përbëhet prej 6 personash, nga të cilët 5 janë personel ndihmës akademik dhe një personel ndihmës akademik/ administrativ (Dokumenti nr. I.16). Stafi ndihmës akademik është i kualifikuar, mbasi 5 prej tyre kanë studiuar dhe janë diplomuar në programet e studimit të Departamentit Kimi Industriale dhe Kimi (Dokumenti nr. I.26).</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga këto departamente: Departamenti i Biologjisë, Departamenti i Bioteknologjisë, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Informatikës, Departamenti i Kimisë, Departamenti i Kimisë Industriale, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Matematikës së Aplikuar, Qendra Kërkimore e Florës dhe e Faunës.</p> <p>DKI ka në përbërje të tij 19 lektorë me kohë të plotë, si Personel Akademik, nga të cilët 3 mbajnë titullin akademik “Profesor Doktor”, 4 “Prof Asoc” 10 kanë gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe 2 asistentë lektorë kanë gradën “MSc”. Gjithashtu, DKI ka në përbërje dhe 6 (gjashtë) anëtarë personel ndihmës akademik (Dokumenti nr. I.16, Dokumenti nr. I.24).</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit (Dokumenti nr. I.6) dhe Rregulloren e programit të studimit (Dokumenti nr. I.20), disponohen nga Departamenti i Kimisë Industriale, si njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”. Dokumentacioni vërehet se plotëson dhe është në përputhje me VKM-së për elementet e programeve të studimit. Sa më sipër janë në dispozicion të grupit të vlerësimit: Rregullorja e Univesitetit të Tiranës (Dokumenti nr. I.8),</p>

	Rregullorja e programit të studimit Bachelor KTU (Dokumenti nr. I.20), Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” me informacion mbi disiplinat të grupuara në kategoritë përkatëse (Dokumenti nr. I.16). Programet e lëndëve (syllabus-et) të nënshkruara nga hartuesit/ titullarët e tyre (Dokumenti nr. I.10), Suplementi i Diplomës (Dokumenti nr. II.6), Personeli akademik për realizimin e programit të studimit (Dokumenti nr. II.7), Kriteret e pranimit të studenteve në këtë program studimi (Dokumenti nr. II.12).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor KTU, në përputhje Rregulloren e UT ³ dhe VKM Nr. 41, është i organizuar në elementët kryesorë të mësimin në auditor të cilat janë: leksionet, seminarët/ ushtrime, punët laboratorike, dhe forma të studimit individual të cilat janë: detyrat e kursit, relacione të punëve laboratorike, përgatitje për provim etj. Praktika profesionale, si element formues nuk është parashikuar në kurrikulën e programit të studimit bachelor mbasi është parashikuar në kurrikulën e Programit Master. Kjo është një mangësi të cilën edhe stafi i PS e vë në dukje por në RVB justifikohet me faktin që: me studentët e vitit të tretë organizohen vizita dhe praktika ditore në insitucionet (kompanitë e industrisë ushqimore ose laboratorët e analizave të ushqimeve) me të cilat FSHN dhe UT ka marëveshje bashkëpunimi (Dokumenti nr. I.16).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në KTU është i organizuar në 30 lëndë/ module gjithësej (nga të cilat 27 module të detyruara dhe 3 module me zgjedhje) të cilat janë të vlerësuar në total me 180 kredite ECTS, të ndara në gjashtë semestra. Çdo semester ka 30 kredite. Në semestrin e gjashtë përgatitet Provim Formimi si detyrim përmbyllës i studimeve që vlerësohet me 4 kredite. Numri total i krediteve në programin e studimit të Kimisë Teknologjisë Ushqimore, është i shpërndarë sipas veprimtarive formuese, të kërkuara dhe specifikuar sipas VKM nr 41 pika 2.4. Nga dokumentat në dispozicion dhe nga RVB shihet që për programin e studimit të ciklit të parë bachelor KTU, kjo shpërndarje është si me poshtë: Lëndë të veprimtarisë formuese të kategorisë A janë 7 module me 53 kredite që përbëjnë 29% të krediteve totale; Lëndë të veprimtarisë fomuese të kategorisë B janë 13 module me 90 kredite që përbëjnë 50 % të krediteve totale. Lëndë të veprimtarisë fomuese të kategorisë C janë 6 module (ku 3 module me zgjedhje) me 24 kredite të cilat bëjnë 13%. Lëndë të veprimtarisë fomuese të kategorisë D janë 3 module me 9 kredite që përbëjnë 5%. Lëndë të veprimtarisë fomuese të kategorisë E - 1 modul, detyrimet përmbyllëse me provim formimi me 4 ECTS që përbën rreth 3%. Lëndët e tipologjisë A+B përbëjnë 79% të moduleve totale të kurrikulës së programit të studimit. Kategorizimi është bazuar në VKM Nr 41.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku	Në planet mësimore të vëna në dispozicion janë të detajuara ngarkesat mësimore, orët në auditor (leksion, seminar, laboratore) dhe orët jashtë

<p>përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>auditorit/ studim individual, frekuentimi/ ndjekja ose pjesëmarja e lëndës të programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve. (VLV ose provim me shkrim dhe/ ose gojë). Gjithashtu në RVB, si edhe nga takimi me stafin e programit të studimit, u theksua që në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi Rregullore e UT (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit Tiranës, Neni 3, fq. 2 dhe Neni 39, fq. 24) “<i>çdo fakultet mund të përcaktojë edhe elementë të tjerë të punës mësimore, veçanërisht në fushën e kontrollit të dijeve.</i>” Më FSHN studenti vlerësohet gjatë vitit për aktivizimin sipas veprimtarive formuese të specifikuar në syllabus: psh për: frekuentim 5%-10%; aktivizim në seminare/ushtrime deri 10% - 15%; njohuri dhe shprehi praktike të përvetësuara në laboratore 15% deri në 25%, vlerësimi në provimin final është 70% - 75% të vlerësimit përfundimtar. (Për pjesën më të madhe të moduleve). Në lidhje me kontrollin e dijeve, mënyra kryesore e vlerësimit përfundimtar të dijeve është me provim me shkrim i cili për shumë lëndë në programin e studimit Bachelor KTU zë 60% deri 75% të vlerësimit përfundimtar. (pak module aplikojnë provim me shkrim /gojë) [Dokumenti nr. I.20 Rregullore e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, Neni 11 fq. 8], kjo është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi Rregullore e UT (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit Tiranës, Neni 45, fq. 26 dhe Neni 46, fq. 27).</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion, takimet me stafin akademik të programit të studimit si edhe studentët e këtij programi u vu re se: Programi i studimit KTU përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit dhe kurrikulën përkatëse realizohet përmes veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë së studentëve. Gjithashtu studentët pohojnë se informimi i tyre realizohet edhe nga takimet me kujdestarët (Dokumenti nr.I.35). Nëpërmjet faqes zyrtare të FSHN, studentët konfirmojnë se marrin informimin e tyre për programet e studimit, syllabuset përkatëse, orarin mësimor, detyrimet, orarin e provimeve (Dokumenti nr. II.17) dhe njoftimeve të tjera që lidhen me kriteret e pranimit të studentëve (Dokumenti nr. II.12), rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit Tiranës, Nenet 78 & 79, fq. 37-38), si dhe për të drejtën dhe dokumentat që nevojiten për përfitime të bursave të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit bachelor KTU, përmban të gjitha informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara që i referohen VKM 41/2018. Modeli i Syllabusit (Dokumenti nr. I.16) ka disa elemente kryesore: Programi i studimit ku ofrohet lënda, Ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore, leksion, seminar, laborator etj.), Tipologjia e lëndës, Viti akademik/semestri kur zhvillohet, Lloji i lëndës (e detyrueshme ose me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 21

	zgjedhje), Titullari/ pedagogu i lëndës, Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës, Temat e programit, Mënyra e kontrollit të dijes (frekuentimi dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve), Literatura bazë (të detyrueshme) dhe e rekomanduar. Versioni i shkurtuar i Syllabuseve gjënden të publikuara edhe në faqen elektronike të FSHN (https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-kimise-industriale).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në programin e studimit Bachelor KTU në tre vitet e fundit janë bërë ndryshime në drejtim të përmirësimit të raportit të ngarkesave të elementeve formues të mësimit: leksion/seminar ose seminar, ushtrime/ laborator. Kjo pasqyrohet në ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e mëparëshme të liçensuara (Dokumenti nr. I.16, Dokumenti nr.I.10), dhe tabelat me numër 10 dhe 11 të Aneks RVB. Procedura e realizimit të ndryshimeve kalon; nga propozimi i grupeve mësimore kërkimore të DKI në Dekanat deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UT-së, në rastin kur masa e ndryshimit të kërkuar nuk e kalon masën 20% (Dokumenti nr. II.20).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ngarkesa e programit të studimit Bachelor në KTU është strukturuar në përputhje me Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”, dhe studimet e programit ofrohen me kohë të plotë dhe i përkasin nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Ky PS zhvillohet në 3 vite akademike me nga 60 kredite çdo vit, studentët diplomohen me provim formimi dhe u jepet diploma, Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” (Dokumenti nr.II.5). Sipas VKM Nr. 41, datë 24. 01. 2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”: 1 kredit është 25 orë mësimore, viti akademik përmban 1500 orë (orë në auditor dhe orë punë të pavarur, studim individual). Orët e studentit për punë të pavarur zenë jo më pak se 50% të orëve të përgjithshme prej 1500 orëve mësimore vjetore.</p> <p>Aktualisht për vitin akademik 2020-2021 orët në auditor në programin KTU janë gjithësej 1920, 5 këto të ndara sipas veprimtarive formuese: leksione, ushtrime/ seminare dhe laboratore (Dokumenti nr. I.16).</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UT (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit Tiranës, Neni 33, fq. 22), Rregulloren e Departamentit Kimi Industriale (Dokumenti I.6 dhe Rregulloren e programit të studimit KTU (Dokumenti I.20 Rregullore e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, Neni 3, fq. 3): semestri është i organizuar në 15 javë mësimore dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. (semestri VI ka 14</p>

	<p>javë), ngarkesa javore e studentit në auditor për secilin semester nuk e kalon 25 orë (Dokumentit II.14).</p> <p>Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, janë pjesë e “struktures akademike” dhe shpallen në faqen zyrtare të Njësisë Kryesore FSHN (Dokumentit II.17).</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi (KTU), përmbajtja e veprimtarive që i referohen fushës së kimisë dhe teknologjisë ushqimore, shpërndarja e lëndëve sipas structures që u përmend me detaje më sipër, njohuritë dhe aftësitë e marra gjatë viteve të studimit i mundësojnë studentët që të plotësojnë kërkesat bazë për punësim e tyre. Ky PS KTU duket që prek një fushë me shumë interes për ekonominë vendore atë teknologjisë ushqimore, por gjithashtu studentët e këtij programi studimi janë potencialë edhe për industrinë kimike dhe farmaceutike, gjithashtu edhe për bujqësinë etj. Stafi akademik dhe studentët e PS pohojnë se nëpërmjet seancave laboratorike të zhvilluara dhe të realizuara gjatë 3 viteve akademike studenti fiton kompetenca të avancuara në fushën e Kimisë ushqimore si dhe aftësi praktike (Dokumentit nr. I.10) të cilat mundësojnë punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, eksperiencën në vite të Programit të studimit Bachelor “KTU” vërehet se organizimi i këtij PS mundëson arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional, gjatë tre viteve akademike (180 kredite), gjashtë semestre (nga 60 kredite secili) dhe në fund të vitit të tretë provimi i formimit 4 kredite. Sipas dokumentave në dispozicion dhe RVB konstatohet që: Në vitin e parë të studimit në dy semestra studenti merr njohuri mbi lëndët e formimit të përgjithshëm: Kimi e Përgjithëshme, Kimi Inorganike, Matematikë, Fizikë, Informatikë, Gjuhë e huaj. Lëndët me zgjedhje që zhvillohen në këtë vit: Shkenca mbi ushqimin ose Bazat e teknikës laboratorike, janë një hyrje në shkencat mbi kiminë dhe teknologjinë ushqimore. Këto lëndë së bashku me kiminë organike që zhvillohet në vitin e dytë janë baza për të kuptuar dhe përvetësuar disiplinat e tjera karakterizuese, plotësuese integruese dhe aplikative në kimi dhe teknologji ushqimore.</p> <p>Këto disiplina zhvillohen kryesisht në vitin e dytë të programit, ku vendin kryesor e zënë disiplinat e Kimisë Analitike, Kimisë Organike, Kimisë Fizike–Koloidale, Metodave Instrumentale të Analizës, dhe Bazat e Transmetimit të Masës, Nxehtësisë. Secili modul në veprimtaritë formuese të tij ka orë leksion/ orë ushtrime/ orë laboratorike. Raporti orë leksioni/orë praktikë laboratorike në disa module është në favor të orëve laboratorike dhe për të tjerat është i barabartë (Dokumentit nr. II.13).</p> <p>Në vitin e tretë studenti pajiset me njohuri të disiplinave kryesisht karakterizuese dhe aplikative për programin e studimit. Këto mund të grupojmë në tre kategori kryesore. Së pari modulet: Kimi dhe Teknologji Ushqimore I dhe II, Mikrobiologji Ushqimore I, Mikrobiologji II e ushqimeve të fermentuara, Enzimologji, të cilat janë shkencat kryesore të përpunimit teknologjik të lëndëve të para.</p>

	<p>Grup lëndët e karakterit inxhinierik: Kontrolli i Proceseve në inxhinieri kimike, Procese dhe Impiane në inxhinierine kimike, Inxhineria e reaksioneve kimike.</p> <p>Në lëndët me zgjedhje studenti merr njohuri mbi Analizat sensoriale/Sistemet dhe ekuilibrat ushqimore.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit ka përcaktuar qartë, ndarjen e orëve mësimore në auditor, për leksionet, seminarët apo orët laboratorike për çdo disiplinë bazuar në numrin e krediteve që ka secila prej tyre (Dokumenti nr. I.16).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga dokumentat e vëna në dispozicion rezulton se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe gjithashtu duke qënë një program bazal ka përafime me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe në sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS).</p> <p>Struktura e programit në lidhje me lëndët, veprimtaritë mësimore dhe kreditet është e ngjashme me programe të tjera të Kimisë dhe Teknologjisë në institucione të tjera homologe dhe kjo ka mundësuar procesin e ekuivalentimeve të lëndëve për transferimet dhe për studime në degë të dyta.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter vërehet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Departamentin e Kimisë Industriale, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Mësim në auditor, si: leksione, seminare, ushtrime, orë laboratorike, forma të kontrollit të vazhdueshëm të zhvilluara në auditor. Studim individual, si: studim dhe punim relacionesh, detyrash apo projektesh dhe përgatitje për provimin e diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të PS, verifikimi i syllabuseve të lëndëve/moduleve vërehet se DKI ju siguron studentëve literaturën bazë, në formën e teksteve mësimore me autorë pedagogë të FSHN, UT si dhe materiale leksionesh të përgatitura nga pedagogët e Departamentit. Tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve miratohen çdo fillim viti akademik nga departamenti, me propozimin e titullarëve të lëndëve.</p> <p>Siç pohohet nga stafi akademik dhe studentët e programit Bachelor KTU rreth 80 % e moduleve (24 module) është me tekste mësimore. Studentët shprehen komodë me cilësinë e teksteve, gjithashtu ata përdorin leksionet e shkruara për lëndët me zgjedhje dhe disa disiplina integruese (Dokumenti nr. II.3). Literatura pasqyrohet në programin e lëndës në Syllabus (Dokumenti nr. I.10), ajo përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse, plotësuese. <i>Në syllabuset e paraqitura vihet re se një pjesë e literaturës është e vjetër. Ky fakt justifikohet me të qenit "literature bazë" e shkencave ekzakte. Stafi pohon se ata i përditësojnë leksionet duke përdorur tituj të specialitetit bashkëkohor, të botuara jashtë ose tekste të shkarkuara nga interneti.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton</p>	<p>PS Bachelor në KTU ka në përmbajtjen e tij formimin bazë në profesionin e kimistit, analistit, teknolog, mikrobiolog, inxhinierit kimist</p>

<p>përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>ndaj mund të vazhdojnë formimin e tyre në programet Master Profesional e Master Shkencor (të paraqitura dhe në faqen web- it) të Departamentit të Kimisë Industriale (https://fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-kimise-industriale/Programmes/kimi-industriale-bsc) në fushat: Kimi, Shkencat e Ushqimit, Bioteknologji dhe Inxhinieri Kimike; të cilat janë ofruar jo vetëm në FSHN-UT por edhe në IAL të tjera brenda vendit që ofrojnë programe të ngjashme studimi.</p> <p>Kompetencat që synon ky PS në Bachelor në KTU ju japin mundësi studentëve të ndjekin studime të ciklit të dytë edhe në universitete jashtë vendit, të cilët kanë ndjekur studimet nëpërmjet aplikimit të mobiliteteve Erasmus+ (Dokumenti nr. II.23). Struktura e programit synon ti përshtatet kualifikimit të vazhduar në përputhje me nevojat e tregut.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nga dokumentacioni i PS vërehet se përmbajtja e tij e mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve pasi studentët janë të pajisur me njohuritë bazë të nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të studimit dhe u përgjigjet kërkesave me të cilat ata mund të përballen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Nga takimet me studentët ata pohojnë se gjatë viteve të studimeve ata marrin njohuritë bazë dhe specifike të hollësishme në lidhje me shumë aspekte të Kimisë dhe Teknologjisë Ushqimore.</p> <p>Gjithashtu në evidencat në dispozicion dhe në RVB shkruhet se: Tregu i punës për të diplomuarit në Bachelor Kimi dhe Teknologji Ushqimore ofron shumë mundësi përfshirje të këtyre studenteve, sepse industria ushqimore e përpunimit të lëndëve të para bujqësore dhe blegtorale është nga më të zhvilluarat në vend. Nga të dhënat e sekretarisë mësimore, pjesa më e madhe e atyre që diplomohen pas ciklit të parë preferojnë të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë në programet Master Shkencor (Dokumenti nr. I.15).</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimet me dekanin e FSHN-së dhe personelin akademik të PS vihet në dukje se ata bashkëpunojnë në mënyrë të vazhduar me biznesin, për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. UT, FSHN organizojnë Panairt e Karrierës (https://unitir.edu.al/panairi-i-karrieres-eksploro-boten-tende-2/ https://unitir.edu.al/panairi-i-karrieres-eksploro-boten-tende/) për të ndihmuar studentët në një përfaqje më të mirë ndaj tregut të punës, si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi.</p> <p>Në këto panire marrin pjesë subjekte publike dhe private, ku diskutohen mundësitë për marrëveshje bashkëpunimi (Dokumenti I.49), si dhe konsultime për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Departamenti i Kimisë Industriale (Dokumenti nr. I.42 Raporti Vjetor i Fakultetit të Shkencave Natyrës për vitin akademik, a) 2019-2020 fq.18 dhe 2020-2021 fq. 13) ka të realizuara disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës që mbulon Departamenti i Kimisë Industriale si p.sh Kantina e Pijeve “Gjergj Kastrioti”, Lufra, Fabrika Stela, Klegen etj. Gjithashtu, përmirësimi i programeve realizohet gjithashtu edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme (Dokumenti nr. I.45). Sikurse pohohet dhe në RVB: për periudhën 2019-2023 UT ka nënshkruar 42 marrëveshje, në kuadër të programit</p>

	Erasmus+KA107, të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës (https://unitir.edu.al/marrevshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/). Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit (Marrëveshjet ERASMUS + KA107 të nënshkruara nga Universiteti i Tiranës. https://unitir.edu.al/arkiva-marrevshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie në Programin e Studimit Bachelor KTU me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Nga kontrolli i dokumentacionit në zyrën përkatëse ku disponohet ky informacion, në prani të koordinatorit të programit të studimit, u vu re që: rekrutimi i stafit akademik kryhet në përputhje me kategoritë e Personelit Akademik, sipas specifikimeve në Ligjin e Arsimit të Lartë, Rregullore e Statutin e UT.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Përbërja e personelit akademik të DKI që ofron programin e studimit Bachelor KTU që angazhohen me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit (Dokumenti nr.I.16). Gjithsej për të tre vitet e fundit na rezultojnë: pedagogë të brendshëm të departamentit 10 nga të cilët 1 Profesor, 2 Professore të asocijuar, 7 doktorë, pedagogë të jashtëm të departamentit për këtë program 2 me gradën “doktor”. Totali i orëve të mbuluara nga pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Departamentit 1596 orë , totali orëve mbuluar nga pedagogë të brendshëm- 1561 orë . Totali i orëve mbuluar nga të jashtëm 35 orë . Nga përllogaritjet për 3 vite: Viti I- 28 orë-pedagog i brendshëm, Viti II- 140 orë pedagogë të brendshëm, Viti III - 1428 orë gjithsej, 1393 orë pedagogë të brendshëm dhe 35 orë pedagogë të jashtëm. Nëse llogaritet 100% <u>ngarkesa totale e programit</u> - 1561 orë të mbuluara nga stafi i departamentit atëherë: në vitin e parë 1.79% mbulohej nga të brendshëm, në vitin e dytë 8.97% mbulohej nga të brendshëm, në vitin e tretë 89.2% mbulohej nga të brendshëm (referuar 1561 orëve) dhe nëse 1428 orë llogaritet 100%, atëherë 97.5% mbulohej nga të brendshëm dhe 2.5% mbulohej nga të jashtëm të departamentit. Shënim: Ngarkesa e ulët e pedagogeve të departamentit në vitin e parë dhe të dytë lidhet me zhvillimin e lëndëve të përgjithshme si matematika, fizika, kimia-kimia inorganike, kimia organike, kimia fizike, kimia analitike, pasi këto lëndë janë <u>domosdoshmëri</u> për përgatitjen e të

	<p><i>diplomuarve në Kimi dhe Teknologji Ushqimore. Vlerësimi i studentëve në këto lëndë i paraprin lëndëve të profesionit dhe për këtë arsye rreth 90% e programit të vitit të tretë mbulohet nga lëndët e profesionit.</i></p> <p>Niveli i personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme të angazhuar në programin e studimit KTU është i duhuri dhe me kërkesa sistematike për rritjen e tij.</p>			
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar jetëshkrimeve të personelit akademik dhe lëndëve që ata mbulojnë në këtë program studimi GVJ konstaton se niveli i kualifikimit dhe fusha ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet me lëndët që ata mbulojnë. Titujt akademikë janë përmendur në Kriterin 2.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka kushtuar rëndësi të veçantë cilësisë së personelit akademik dhe ndihmës akademik, duke garantuar shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>Fakti që PS Bachelor në KTU nuk parashikon praktika profesionale në terren gjatë ciklit tre vjeçar të studimit, ka bërë edhe më të domosdoshme siç e pohon edhe stafi akademik bashkëpunimin dhe lidhjen e marrëveshjeve me institucione qeveritare, universitete brenda dhe jashtë vendit, shoqata dhe kompani private që operojnë në fushën e ushqimit me të cilat organizon vizita me studentet, të shoqëruara nga pedagogët.</i></p> <p>Studentët pohojnë interesin e tyre për sa më shumë trajnime ose intershipe në ndërmarrje të ndryshme të profilit të programit të studimit KTU si p.sh Kantina e Pijeve “Gjergj Kastrioti”, Lufra, Fabrika Stela, Klegen, AKU etj. të cilat pasqyrohen në Tabelën 5 të aneks RVB (Dokumentit I.16, Tabelat përmbledhëse Aneks RVB ASCAL, Tabela 5). Diplomimi realizohet me provim formimi që vlerësohet me 4 ETCS, pyetjet e tezave janë nga temat kryesore të 4 moduleve karakterizuese të programit që zhvillohen në vitin e tretë të studimit (Dokumentit II.25).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik i angazhuar është i specializuar në fushën përkatëse dhe me përvojë. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborante, teknike) ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT



Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Konstatohet se; Universiteti i Tiranës, ka të miratuar udhëzuesin për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë (Dokumenti III.3) në kuadër të zhvillimit dhe të përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Metoda inovative që përfshin format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin është E-learning e cila zhvillohet me ndihmën e paisjeve elektronike. Metodatat dhe qasjet e mësimin elektronik kanë ndihmuar stafin akademik të përdorë teknikat audiovizive, të krijojë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënies (leksione të shkruara dhe poërpoinit, dhe video me teknikat laboratorike për shumicën e lëndëve) [Dokumenti nr. I.20 Rregullore e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, Neni 14] dhe (Dokumenti III.2). Në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 si në të gjitha universitetet shqiptare edhe në UT u zhvillua platforma online e mësimdhënies për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19 dhe pezullimit të procesit mësimor në auditor. Në sajë të implementimit të mësimin online si një metodë e re, u arrit që procesi mësimor në Programin e Studimit Bachelor KTU të finalizohet me sukses në kushtet e pandemisë (Dokumenti nr. III.3 dhe Dokumenti nr. III.4).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të PS u vërejt motivimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve përmes zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore. Në RVB, në lidhje me mësimdhënien, Programi Studimit Bachelor KTU ka objektiv kryesor adoptimin e metodologjisë interaktive që inkurajon të menduarin kritik dhe individual tek studenti. FSHN është një institucion që ka synuar gjithmonë që përmes programeve të studimit të orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe bashkëveprimit ndërdisiplinor dhe t’i përgatisë ata për tregun e punës (Dokumenti nr. I.7 dhe Dokumenti nr. I.20). Gjithashtu theksohet se mësimdhënien mbetet aktiviteti kryesor i personelit akademik dhe si rrjedhim i nënshtrohet monitorimit të vazhdueshëm në mënyrë të sigurimit të cilësisë. Monitorimi kryhet në nivel fakulteti, (njësisë kryesore) bazuar edhe në statutin e UT (Dokumenti I.2 Statuti i UT, Neni 138, pika 1, fq. 73).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët pohohet se; pedagogët e tyre i inkurajojnë ata të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor, si edhe të kenë të drejtë të vlerësojnë dhe ofrojnë mendimet e tyre për modulet e Programit të Studimit, strukturën e tij dhe procedurave të vlerësimit të lëndëve. Ata pohojnë se janë pjesë e anketimeve që zhvillohen në fund të çdo semestri. Në anketime kryen vlerësime periodik i formave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve nga ana e studentëve është ligjëruar në disa prej rregulloreve si: Rregullore e Universitetit të Tiranës (Dokumenti nr.I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës: Neni 23.pika 3;</p>

	fq. 15-16 dhe Neni 24, fq. 16), Statutin e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor KTU (Dokumenti nr. I.20).			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga kontrolli i dokumentacionit në dispozicion rezulton se; Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, në FSHN, në respektim të ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 për mbrojtjen e të dhënave personale, publikon në mënyrë periodike, rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi (Dokumenti nr. 3.9 dhe Dokumenti nr. 6.8).			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Bashkëpunimet dhe shkëmbimi i eksperiencave, sidomos në programet e mobilitetit Erasmus+ për trajnime në mësimdhënie (Dokumenti nr. 2.27) është një indikator që stafi akademik e argumenton në rastin e për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. FSHN për këtë kriter na jep rastin e promovimit të praktikave të mira nga përfshirja në projektin NETCHEM (Dokumenti nr.1.31), nëpërmjet së cilit stafi akademik është trajnuar në mënyrë të vazhdueshme për metodat inovative të mësimdhënies në përputhje me profilin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit dhe nga dokumentat rezulton se: format e mësimdhënies dhe transmetimit të njohurive në Programin e Studimit Bachelor KTU janë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, të cilat janë të detajuara në Planin mësimor të Programit të Studimit dhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi. Të gjitha format e lartpërmendura janë në përputhje me modelin e dhënë në VKM-në Nr 41/2018. Gjithashtu një formë tjetër e mësimdhënies që i shërben njëkohësisht përmirësimit, përditësimit, shkëmbimin e eksperiencave më të mira mësimdhënëse, janë leksione të hapura me profesorët e ftuar dhe me stafin e departamentit (Dokumenti nr. I.50).
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në	Për këtë kriter u diskutua me studentët si edhe stafin akademik të programit të studimit, në lidhje me mësimdhënien, pedagogët dhe stafi ndihmës akademik respektojnë rregullat e institucionit të përcaktuara në Statutin e UT (Dokumenti I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 125, pika 5, fq. 69), si edhe në Rregulloren e Programit Studimit KTU. Diversiteti dhe nevojat e studentëve për një përthithje më të mirë për çdo lëndë me specifikat e veta, ka bërë që pedagogët të zgjedhin forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik me atë praktik, duke nxitur diskutimin dhe interaktivitetin. Ata pohojnë se kjo është realizuar nëpërmjet përgatitjes dhe prezantimit



<p>përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>të detyrave ose projekteve të kursit individuale ose në grup dhe diskutimit në auditor të argumentave të ndryshme, raste ushtrimore ose raste studimi të kërkimit shkencor, që plotësojnë dhe pasurojnë tematikat e zhvilluara në leksion. Studentët preferojnë formatin “Poëer Point”, si edhe videot demonstruese, pra mënyra audiovizive (Dokumenti nr. III. 42). Studentët që u takua grupi i RVJ kanë përjetuar në dy vitet e fundit problemet e pandemisë Covid-19. Ata shprehen se mësimdhënia që u realizua “online” nëpërmjet platformës Microsoft Teams (Dokumenti nr. III.2), megjithvse nga pedagogët u bë maksimumi, ata kanë patur vështirësi për ta suportuar. Kthimi në normalitet ju ka dhënë më shumë shanse për përvetësimin e dijeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga vetë personeli akademik i programit të studimit pohohet se ata mbështeten institucionalisht në aspektin e zhvillimit dhe përmirësimit të kompetencave didaktike, si edhe teknologjive elektronike bashkëkohore të mësimdhënies. Duke ju referuar edhe objektivave të programit të studimit dhe specifikave të tij, stafit akademik dhe ndihmës akademik ju është mundësuar përdorimi i metodave të përshtatshme, të shumëllojshme dhe fleksibël, ato janë metoda të shumëllojshme pedagogjike të zhvillimit të mësimin, duke dhënë impakt pozitiv tek studentët përsa i përket rezultateve të pritshme të të nxënit si edhe objektivave formues të programit (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Nenet 37-39, fq. 23-24). Gjatë pandemisë Covid 19, siç edhe u përmend më sipër u vunë në funksion të mësimdhënies disa platforma të komunikimit online si “Google Classroom”, “Microsoft Teams” (https://api.fshn.edu.al/uploads/Udhezues_i_UT_per_mesimin_ne_distance) lehtësisht të përdorshme edhe nga aparatet celular, metodë kjo e preferuar nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga CV e personelit akademik: [19 me kohë të plotë personel akademik efektiv (PAE) dhe 13 personel akademik me kontratë (PAK) dhe personel ndihmës-akademik], të angazhuar në mësimdhënie per vitin akademik 2021-2022, rezultojnë se ata janë të kualifikuar, me tituj e grada shkencore dhe kanë specializime në fusha të ngushta specifike, brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu procesi i kualifikimit të tyre është në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit të moduleve që ata i përkasin.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përgjegjësi i DKI na pohon në lidhje me këtë kriter se departamenti dhe stafi akademik i tij ka në fokus përmirësimin e metodave të mësimdhënies duke i përfshirë edhe studentët në këtë proces. Është Senati akademik ai që miraton Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, ku në përbërjen e tij për përmirësimin e kurrikulës përfshihen edhe studentë nga njësitë kryesore të UT (Dokumenti nr. III.10). Gjithashtu mendimet dhe sygjerimet e tyre realizohen edhe nëpërmjet anketimeve (Dokumenti I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 125, fq. 69). Rezultatet e anketimit merren në konsideratë në Raportin Vjetor të FSHN (Dokumenti nr. I.42, Dokumenti nr. VI.12, Dokumenti VI.11), ku edhe konsiderohen përmirësimet e tyre sipas rregullores.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Ky kriter është në fokus të diskutimeve me Personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në KTU. Ata përdorin</p>

diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	metoda interaktive duke i konsideruar si mjet për të bërë më tërheqëse orët e mësimit. Ata pohojnë se modulet me laboratore kur ata nuk i kanë realizuar dot për shkak të kushteve të krijuara i kanë bërë si “laboratore virtuale”. Seminaret dhe diskutimi interaktiv është realizuar nëpërmjet përgatitjes dhe prezantimit të detyrave ose projekteve të kursit, individuale ose në grup, dhe diskutimit në auditor të argumentave të ndryshme që pasurojnë tematikat e zhvilluara në leksion (Dokumenti nr. I.5, Dokumenti nr. II.4).			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët e programit të studimit rezulton se format dhe metodat e mësimdhënies i inkurajojnë ata në realizimin e detyrave individuale duke ju dhënë sensin e autonomisë dhe në të njëjtën kohë duke ju siguruar mbështetjen nga pedagogët e tyre. Në syllabusin e secilës lëndë të programit, evidentohen dhe format e metodat e mësimdhënies, të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit (Dokumenti nr.III.11). Studentët pohojnë se përgatitja e projekteve dhe detyrave të kursit të cilat janë punë individuale ose në grup i nxitin ata të jenë të pavarur dhe të rrisin sigurinë e tyre në komunikim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita e realizuar në mjediset e FSHN vihet re që: Procesi mësimor e shkencor i programit të studimit KTU realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Infrastruktura e mësimdhënies është e përshtatshme dhe garanton më së miri realizimin e procesit mësimor. Në mjediset e DKI vihet re një investim i dukshëm në laboratorët që sic edhe pohohet nga pedagogët janë themeli i formimit të aftësive dhe kompetencave praktike laboratorike për studentët e Programit të Studimit Bachelor KTU. Godina A e FSHN është godina kryesore e zhvillimit të procesit mësimor. Aty gjenden të gjitha laboratorët e kimisë: laboratorët e Kimisë të Përgjithëshme dhe Inorganike, të Kimisë Organike, Kimisë Fizike dhe Koloidale, Kimisë Analitike dhe laboratorët e Kimisë e Teknologjisë Ushqimore, të Proceseve të inxhinierisë Kimike, dhe laboratorit i Mikrobiologjisë Ushqimore, (ku zhvillojnë seancat laboratorike vetëm studentet e këtij Programi Studimi). Sic shkruhet në RVB: Këto laboratore kanë sipërfaqe secili prej 48m ² dhe punojnë njëkohësisht maksimumi 15 studentë/ minimum 12 studentë; (shembuj: Laboratori i Mikrobiologjisë ushqimore salla 104/A dhe Lab i KTU salla 107/A me indeks 3,2 m ² për student deri në 4m ² për student) [Dokumenti nr. I.22 , Dokumenti nr. I.18]. Në funksion të mësimdhënies janë edhe ambjentet e leksioneve dhe seminareve që zhvillohen në sallat e

	<p>Godinave A/B/C/D, 18 salla leksione me 1663 poste studenti dhe sipërfaqe totale 2167m² dhe 10 klasa mësimi seminare me 503 poste studenti dhe sipërfaqe totale 404 m² Nga këto në përbërje të Godines A janë 3 salla leksionesh dhe 8 klasa mësimi për seminare (Dokumenti nr. I.16 Tabelat përmbledhese aneks RVB ASCAL, Tabela 16).</p> <p>Departamenti i Kimisë Industriale ofron ambiente laboratorike dhe mjedise pune (zyra) me sipërfaqe totale 630 m², nga të cilat janë mjedise laboratorike 349 m² (Dokumenti nr. I.22). Kapaciteti total i Godinës A është 588 poste studenti me sipërfaqe totale 50262 m².</p> <p>Godina B ka 4 kate dhe ka në përbërje të saj 4 salla leksioni me kapacitet total prej 328 poste për student dhe me sipërfaqe totale 288.6 m² (Dokumenti nr. I.22).</p> <p>Godina C ka 3 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla të cilat përdoren kryesisht si salla seminari, por në varësi të numrit të studentëve mund të përdoren edhe si salla leksioni (Dokumenti nr. I.22). Kapaciteti total i Godinës C është 486 poste për student me sipërfaqe totale 496.68 m².</p> <p>Godina D ka 6 kate dhe ka në përbërje të saj 6 salla leksionesh me kapacitet total 694 poste studenti dhe me sipërfaqe totale 1107.3 m² (Dokumenti nr. I.22).</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizitat në ambientet e FSHN (Dokumenti nr.I.16 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB ASCAL, Tabela 16) vihet re që ato janë plotësisht të dedikuara për procesin mësimor, janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor: me tavolina dhe karrige, dërrasë të zezë për shkumësa ose <i>Ëite board</i> për lapustil, priza elektrike për përdorimin të laptopit dhe videoprojektorit, perde video projektimi etj. Të gjitha grupet mësimore të Programit Bachelor në KTU kanë numrin e studentëve brenda kapacitetit të klasave ku janë caktuar të zhvillojnë veprimtarinë mësimore sipas orarit mësimor (Dokumenti nr. I.18, Dokumenti nr. III.12).</p> <p>Gjithashtu nga vizitat e bëra në laboratore vihet re që në to janë të gjitha aparaturat e nevojshme të kryerjes së analizave apo demonstrimit të teknikave që parashikohen në planin mësimor (Dokumenti nr.I.18).</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik si edhe studentët të cilët ndjekin programin e studimit Bachelor në KTU, shfrytëzojnë sistematikisht infrastrukturën e IT-së. Pranë FSHN vepron si asistencë teknike personeli i punësuar për Teknologjinë e Informacionit (Dokumenti nr. I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 63, fq. 40). Adresat zyrtare të email-it të stafit dhe studentëve janë: (emer.mbiemer@unitir.edu.al ose (emer.mbiemer@fshn.edu.al), nëpërmjet tyre realizohet komunikimi staf akademik/ndihmës akademik - student dhe anasjelltas. Në FSHN në kuadër të krijimit dhe funksionimit në UT të Platformës Dixhitale egziston sektori i suportit të Teknologjisë së Informacionit dhe në departament është caktuar një personel për asistencë teknike dhe komunikim më të shpejtë me suportin dhe strukturën e IT-Teknologjisë së Informacionit (Dokumenti nr. IV.37).</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike</p>	<p>GVJ realizoi vizitën në mjediset e Bibliotekës së FSHN në Godinën B. Aty gjendet fondi fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Fondi pasurohet herë pas herë me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti (Dokumenti nr. III.15). Biblioteka UT mund</p>

<p>dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>të që aksesohet edhe “on-line” nga stafi akademik dhe studentët. https://unitir.edu.al/biblioteka-online/-biblioteka. Siç edhe shkruhet në RVB: Literatura bazë e programit Bachelor në KTU në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe në formë të printuar, si tekste mësimore, (për pjesën më të madhe të lëndëve) ose si leksione të printuara për module me zgjedhje (Dokumenti nr. II.3) Lëndë të mbuluara me tekste ne programin e studimit KTU janë 77 %, ndersa lëndë të mbuluara me leksione të shkruara janë 23 %. Tekstet mësimore gjenden në bibliotekën dhe librarinë e fakultetit. Stafi akademik përpiqet që literatura ndihmëse të rekomandohet kryesisht nga biblioteka online, për të pasur akses të lirë ndaj saj (Dokumenti nr. I.16).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e FSHN me vendndodhje në Godinën B, ka në dispozicion tre mjedise: dy janë salla studimi (Salla Fond i hapur i librit dhe Salla Fond i hapur i Periodikut); dhe një mjedis shërbimi i Fondit Kryesor. Ajo ka sipërfaqe të përgjithshme prej 678.75 m², me 136 poste studimi; ku 44 janë për fondin e hapur të periodikut dhe 92 poste për fondin e hapur të librit (Dokumenti I.16 Tabelë përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL, Tabela 16). Në RVB shkruhet që: Biblioteka përmban në total nje fond të përbërë nga 80 018 tituj. Prej tyre 36 600 njësi janë libra e monografi shkencore (1158 në shqip, 35443 në gjuhë të huaj), 896 njësi disertacione (858 në shqip, 38 në gjuhë të huaj) dhe 24451 njësi revista e periodikë shkencorë (64 shqip dhe 24387 në gjuhë të huaj) [Dokumenti I.42]. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës ka dixhitalizuar katalogun bibliografik të bibliotekës dhe arkivit nëpërmjet softit Cobiss. Në bibliotekë janë angazhuar 4 punonjës, 3 staf të angazhuar në sigurimin e mbarëvajtjes së funksionimit të bibliotekës dhe 1 staf i Buletinit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentat në dispozicion si edhe nga përshkrimi në RVB në lidhje me libraritë online dhe bibliotekat dixhitale vihet re që ato janë plotësisht në funksion të procesit mësimdhënies/mësimnxënies. Ato janë: JSTOR (ka një gamë të gjerë publikimesh me rreth 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milionë dokumenta në 75 disiplina); Edgar; IOP; ASTM; MPS; COBISS+ si pjesë e marrëveshjes që ka UT me Fondin Shqiptar- Amerikan te zhvillimit (AADF). Në faqen eeb të FSHN-së, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit perkatës (Dokumenti nr. III.17). Aksesimi online në këtë bibliotekë mund të bëhet edhe me anë të e-mailit personal zyrtar. Ky fond është i aksesueshëm edhe për studentët e Programit të Studimit KTU. (https://unitir.edu.al/biblioteka-online/) Për lehtësimin e përdorimit të librarisë dixhitale RASH ka hartuar një manual përdorimi si dhe linkun për aksesimin e saj. https://ulibrary.rash.al/ Për Bibliotekën elektronike online të UT është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA 2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor eëë cobis.net; Biblioteka online COBISS) https://eëë.cobiss.net/, https://al.cobiss.net/en/libraries/.</p>

	EIFL/Informacioni Elektronik për Biblioteka ëëë.eifl.net dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/koordinator për projektin ERA 2012 ëëë .akad.edu.al/era ofron mundësinë ku studentët dhe pedagogët kanë akses në informacion me tekst të plotë.			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	FSHN në funksion të Programit të Studimit KTU ka 20 nga 82 laboratorë gjithësej. Pra një numër i konsiderueshëm dhe plotësisht i mjaftueshëm për realizimin e objektivave të PS KTU. Pesë nga nëntë laboratorë, konsiderohen si unikalë (Dokumenti nr. I.20), kjo prej disa specifikave të tyre si edhe pajisjeve dhe analizave që realizojnë: Laboratori i Teknologjisë Kimike Ushqimore dhe i Analizave të Produkteve Ushqimore, Laboratori i Mikrobiologjisë Industriale dhe Ushqimore, Laboratori 1 i Inxhinierisë Kimike- është i pajisur me kompjutera- 25 poste pune dhe ofron të gjitha praktikat laboratorike dhe mësimdhënie për studentët Bachelor. Laboratori i Modelim dhe Simulimit realizohet nëpërmjet programeve kompjuterike përkatëse, Laboratori 2 i Inxhinierisë Kimike i ndarë në tre seksione dy nga të cilat i shërbejnë programit Bachelor KTU.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Për shkak të pandemisë Covid-19 në FSHN u përdorën platformat online, në vitet akademike 2019-2020 dhe 2020- 2021. Fillimisht në “Google Classroom” dhe më pas në “Microsoft Teams”. Drejtuesi i departamentit dhe dokumentacioni në dispozicion tregojnë që për platformat e mësipërme specialistët e IT morren masa, hartuan dhe vunë në dispozicion udhëzues për stafin dhe studentet për të përdorur këto platforma dhe metodat e-learning.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sistemet e komunikimit të brendshëm në FSHN janë shumë të favorizuara nga stafi i IT-së së FSHN, si fakultet që e ka të përfshirë këtë departament. Kështu personeli akademik dhe studentët kanë përdorur gjerësisht komunikimin elektronik dhe platformën Microsoft Teams jo vetëm për zhvillimin e mësimin online por edhe për komunikim më të shpejtë mes tyre (Dokumenti nr. III.18). Studentët, personeli akademik dhe administrativ kanë adresat e tyre të e-mail me domain të universitetit. Në ëëbsitin e FSHN sikurse u përmend edhe më parë disponohet i gjithë informacioni i nevojshëm i cili është edhe në funksion të komunikimit pedagog – student. UT, gjithashtu ka vënë në funksionim sistemin e-Student dhe ka hartuar Manualin e përdorimit E-student UT 2022 përkatës. Çdo përdorues identifikohet në mënyrë unike sipas të drejtave në sistem.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	N/A			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB janë përmendur strukturat institucionale që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies si psh: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC) [Dokumenti nr. I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 138, fq. 73, Dokumenti nr. III.5], i cili ka për funksion kryesor bashkëpunimin për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky komision është një nga hallkat për vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe njëkohesisht ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu në rang UT funksionon Sektori i Sigurimit të Cilësisë (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/, Dokumenti nr. I.16 Tabela përmbledhëse për Aneks RVB ASCAL, Tabela 24) si strukturë ndihmës akademike që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e KPSSC dhe NJSBC ose DSBCK në njësitë kryesore.</p> <p>Vetë FSHN ka ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBCK) në nivel fakulteti, në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të UT-së (Dokumenti nr. I.16, Tabela përmbledhëse për Aneks RVB ASCAL, Tabela nr.24). Kjo degë ka hartuar pyetësoret për studentët dhe raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. DSBCK ka në përbërje të grupit të punës edhe student.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjës të DKU pohohet se DKU ka përgjegjësinë për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në KTU (Dokumenti nr. I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 24, fq. 16). Organizimi në grupe mësimore-kërkimore dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit nga grupet çon në rritjen e vetëdijes së personelit akademik për të realizuar sa më mirë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Nga takimi me studentët në lidhje me procesin e anketimit, ata pohojnë se ky zhvillohet në çdo fund semestri për çdo lëndë të programit të studimit. Studentët janë të përfshirë jo vetëm në plotësimin e pyetësorit, por kanë rol aktiv në procesin e arritjes së cilësisë. Kjo realizohet me pjesëmarrjen e studentëve në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (Dokumenti nr. I.16 Tabela përmbledhëse për Aneks RVB ASCAL, Tabela 24), si edhe duke i angazhuar ata në fushatat informuese dhe promovuese: për plotësimin e Pyetësorit të Studentëve mbi Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies (Dokumenti nr. VI.15), etj. Kjo praktike mbështetet dhe tregohet në Statutin e Universitetit të Tiranës (Dokumenti nr. I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Nenet 138-141, fq. 73-74, Dokumenti III.5) dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor "KTU" (Dokumenti nr. I.20).</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik të PS u theksua se ata kanë mbështetje nga strukturat e FSHN për aplikimin e metodave të reja dhe inovative në mësimdhënie. Kjo u demonstrua më së miri gjatë periudhës së pandemisë</p>

<p>e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>ku mësimi u realizua online dhe kjo u bë e mundur nga specialistët e IT në Universitetin e Tiranës/ Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Dokumenti nr. III.2). Gjatë kësaj periudhe personeli akademik dhe studentët kanë patur qasje të plotë në platformën dixhitale Microsoft Teams (https://unitir.edu.al/?s=teams). Në RVB pohohet se në funksion të cilësisë të programit të studimit është miratuar Ngritja Qendres Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës (Dokumenti nr. III.23). Sikur pohon edhe drejtuesi i DKİ metoda të reja inovative të mësimdhënies përdoren prej stafit akademik bazuar edhe në inisiativa personale në funksion të moduleve.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik del se ai bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Siç theksohet edhe në RVB krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies si dhe për kualifikimin profesional të stafit akademik. DKİ bashkëpunon dhe me strukturat përkatëse në rektorat për të lehtësuar punën në kërkimin shkencor si edhe aplikimin në projekte institucionale apo ndër-universitare, brenda ose jashtë vendit (Dokumenti nr. III.22, Dokumenti nr. III.1). Stafi i DKİ është i ri në moshë dhe në proces kualifikimi të vazhdueshëm si studime doktorale (Dokumenti nr. III.26), por sidomos në plotësimin e kriterëve për titullin Prof. Asoc. Sa më sipër shihen si obligime jo vetëm për qëllime të përmirësimit të mësimdhënies dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore por edhe për shkallët përkatëse të kualifikimit për gradat dhe titujt akademikë.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Dekani i FSHN, pohon se dekanati mbështet personelin akademik të FSHN për trajnime brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu dekanati i mbështet kërkuesit e rinj për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare jashtë vendit me kushtin që prezantime e tyre të jenë gojore, të jenë autorë të parë dhe konferenca të jetë në vendet e OECD.</p> <p>Në lidhje me trajnimet me shumë interes janë ato të organizuara në bashkëpunim me departamentin dhe strukturat e tjera të UT, ose institucione të tjera që operojnë në fushën e sigurisë dhe cilësisë ushqimore përmes trajnimeve të ndryshme tematike, me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nga ana e stafit akademik të Programit të Studimit.</p> <p>Në RVB thuhet që: Një eksperiencë e frutshme dhe shumë efikase ishte Trajnimi mbi përdorimin e platforms Microsoft -Teams për mësimin online (Dokumenti nr. III.3). Për programet ERASMUS ICM - në bashkëpunim me koordinatorin akademik të Erasmus+ në FSHN (https://unitir.edu.al/bursa-shkembimi-programi-erasmus/), stafi akademik përfiton nga këto marrëveshje për mobilitete të ndryshme. Për periudhën 2019-2023 UT ka nënshkruar 42 marrëveshje, në kuadër të programit Erasmus+KA107, të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës (https://unitir.edu.al/marrevshjet-erasmus-ka1-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/). Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit (https://unitir.edu.al/arkiva-marrevshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/).</p>



<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Vetë personeli akademik i programin studimit KTU pohon se është përgjegjës për zbatimin e tij dhe cilësinë e mësimdhënies duke e konsideruar si detyrim primar i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik me UT (Dokumenti nr. I.39). Për këtë Titullarët e moduleve angazhohen për përgatitjen, dhe përditësimin e syllabuseve dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të parashikuar në të, si pjesë e detyrimeve të akademike tyre.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Sipas takimeve me personelin akademik rezultoi se ata aplikojnë metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur jo vetëm teknologjinë e informacionit (të mundësuar nga institucioni, por edhe nga aftësitë dhe eksperiencat individuale sic u theksua më sipër. Personeli akademik thekson se aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie duke përdorur edhe nxitjen e mendimit individual kritik dhe kreativ të studentëve duke hedhur pyetje për bashkëbisedim. Në RVB thuhet se elementët e mësimdhënies bëhen pjesë e analizës së punës të departamentit në mënyrë periodike, si dhe pjesë e informacioneve e raporteve institucionale (Dokumenti I.42).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor KTU përcakton kriteret dhe mënyrat e kontrollit të dijeve/ vlerësimit në lëndë⁴. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e ecurisë të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave dhe të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Ky kontroll behet me teste me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, prezantimeve, relacioneve të praktikave laboratorike. Në RVB shkruhet që: njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes kombinimit: të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimin në auditor, (seminare, ushtrime), kontrolleve me shkrim, detyrave të kursit, angazhimit në seancat laboratorike.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit na informon se: studentëve që me fillimin e semestrit ju vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që frekuentojnë në programin e studimit. Çdo pedagog në fillim të lëndës i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/ pedagogët e lëndës, viti/ semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, (tipologjia e lëndës) ngarkesa në orë në auditor si dhe orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik</p>

	dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre. Gjithashtu studentët pohojnë se ata marrin të gjithë informacionet e nevojshme nga pedagogët e moduleve. Ata njihen me metodologjinë e testimit gjatë vitit si edhe me format e vlerësimit të tyre, duke përfshirë edhe numrin e kontrolleve të ndërmjetme që do të realizohen gjatë vitit, si edhe me literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar (Dokumenti nr. III.16) .								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale, siç edhe pohohet nga stafi akademik i programit të studimit, përbëhet nga disa komponentë duke aplikuar parimin e kontrollit të vazhdueshëm të njohurive. Sipas RVB komponentët janë: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet zakonisht me 10% të vlerës së pikëve totale, detyra e kursit me 10%-20%, për lëndët që zakonisht nuk kanë të parashikuar praktika laboratorike, angazhimi dhe vlerësimi në labororet e lëndëve ka zakonisht 20%-25% të vlerës së pikëve totale, si edhe provimi përfundimtar ka përafërsisht masën 65%-70% të vlerës së pikëve totale (Dokumenti nr. I.16, Tabelat përmbledhese Aneks RVB ASCAL, Tabela 15) . Tezat e provimit përfundimtar zakonisht ribëhen çdo vit akademik. Provimi me shkrim bëhet me pyetje shtjelluese llogjike ose me pyetje me alternativa. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga përgjegjësi i departamentit (Dokumenti nr. III.27) .								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Realizimi i këtij kriteri përbëhet nga disa komponentë, dhe realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke dhënë në fund rezultatin/ me notën përfundimtare. Në lëndët me vlerësim të vazhduar, studenti testohet deri në 3 herë gjatë semestrit dhe secili testim vlerësohet deri 30% të vlerësimit total (Dokumenti nr. III.28) . Në RVB theksohet që: Shkalla e përvetësimit të dijeve, pra vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%). Në provimin e lëndës studenti hyn me një bonus të pikëve të grumbulluara gjatë vitit sipas elementeve më sipër. Rezultati përfundimtar (pikët gjithësej) konvertohen në notë, duke filluar nga 1 (njëshi) deri në 10 (dhjetë), ku notat nga 1 (një) deri në 4 (katër) janë jokaluese; ndërsa notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) janë kaluese. Kjo tregohet në rregulloret përkatëse; Rregullore e Përgjithshme e UT-së (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e e UT-së, Neni 49, fq. 28) .
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga stafi akademik theksohet se: ky kriter ka qenë shumë i rëndësishëm në kushtet e mësimin online ku UT, gjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, implementoi testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams pra vuri në zbatim sistemin elektronik, MS-Teams për testimin dhe vlerësimin e studentëve (Dokumenti nr. III.3, Dokumenti nr. III.4, Dokumenti nr. III.2) i cili eliminoi forma të ndryshme abuzimi

	dhe garantoj transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm/ të shpejtë të vlerësimit për studentët (Dokumenti nr. III.3) .
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit.	Përgjegjësi i DKI thekson se stafi akademik i PS KTU është përgjegjës për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve. Përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare është titullari i lëndës, ndërsa kur lënda ka edhe asistent, ose pedagogë të tjerë vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen në elementet formuese të lëndës (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 48, fq.27) . Në tezën e hartuar nga titullari i lëndës, në bashkëpunim me pedagogët e tjerë kur ka, vihen edhe pikët për përgjigjet e sakta për secilën pyetje ose rubrike. Në tezë tregohet sa është % e pikëve të grumbulluara për zgjidhje të sakta me të cilën fitohet nota kaluese (kjo zakonisht është 45-50% të pikëve totale të tezës) [Dokumenti nr. III.27] . Teza nënshkruhet edhe tek përgjegjësi i departamentit. Komisioni i provimit përbëhet nga 2 anëtarë dhe përcaktohet nga titullari i lëndës i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit. (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 27, fq. 18 dhe Neni 48, fq.27 dhe Dokumenti I.20 Rregullore e programit të studimit Bachelor KTU , neni 33) .
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Përgjegjësi i DKI pohon se në bazë të Rregullores të Universitetit të Tiranës, provimet me shkrim, zhvillohen në fletë të sekretuara (Dokumenti 1.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 48, fq. 27-28) , pra testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim për lëndët që kanë grupe mësimore me numer të vogël studentësh. Në RVB thuhet: në Programin e Studimit Bachelor KTU grupet mësimore janë me numër të madh studentësh (80-100); ndërkohë që institucioni nuk ka siguruar sekretimin me anë të barcod- it. Gjithashtu aty thuhet që: Sekretimi me një numër mbi tezën është një procedurë që harxhon kohë dhe jo gjithmonë aplikohet. Nëse numri i studentëve të regjistruar është i vogël (15-30 studentë) ose kur provimi bëhet në disa salla, nuk lind nevoja e zhvillimit të tij me sekretim. FSHN ka infrastrukturën e duhur (salla të mëdha leksioni) dhe personel të mjaftueshëm për të monitoruar zhvillimin e provimit. Siç u theksua më sipër gjatë pandemisë, është aplikuar testimi online. Kjo procedurë është zhvilluar sipas platformës M-Teams, nga celulari ose laptopi personal. Mangësia e kësaj procedure është mungesa e monitorimit nga pedagogët, për pasojë ka mungesë transparence (Dokumenti nr. III.4) .
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniti për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Ky kriter i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, shoqërohet nga pedagogu përkatës me komente kur është e nevojshme, për të sqaruar studentin si dhe për ta ndihmuar atë të përmirësohet në të ardhmen. Pedagogët pohojnë se ata lidhen me studentët për të konsultuar zgjidhjet e tezës në rastet kur ata janë të interesuar për këtë. Ata pohojnë se janë të gatshëm të plotësojnë të drejtat e studentëve për tu njohur me zgjidhjen pas provimit, si edhe kanë të drejtën e ankimit brenda 24 orëve nga shpallja e rezultateve. Sa më sipër theksohen edhe në rregulloret përkatëse të UT (Dokumenti nr. I.8) dhe Programit Studimit KTU (Dokumenti I.20) .

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Vetë stafi akademik i programit të studimit pohon se krijon mjedis të tillë që studentët të shmangin maksimalisht të kopjuarit në provime. Gjithashtu nga dokumentat në dispozicion shihet që ka masa në rast të konstatimit të kopjimeve në provime apo detyra kursi studentit i zerohen pikët e vlerësimit (Dokumenti nr. I.8), në lidhje me rastet kur ndeshet si fenomen. Sa më sipër i referohemi: Rregulloreve të Përgjithshme të UT, të Departamentit të Kimisë Industriale, të Programit të studimit “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, etj. (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës, Nenet, 26-29, fq. 17-19 dhe Nenet 45-51, fq. 26-29, Dokumenti nr. I.6, Dokumenti nr. I.20), ku theksohet ndalimi i kopjimit dhe të plagjaturës për detyrat e kursit dhe në provime; si dhe respektimin e Kodit të Etikës në UT.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Për këtë kriter në Rregulloren e përgjithshme të UT-së dhe Rregulloren e programit të studimit KTU theksohet që: Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët bëhet në përputhje me meritën, çdo komponent të tezës së provimit, pyetjet me alternetiva dhe pyetjet me shtjellim kanë të përcaktuar përbri dhe pikët për përgjigje të saktë. Rezultatet e provimit pas korrigjimit hidhen në procesverbal dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare (Dokumenti nr. 1.8, Dokumenti nr. I.20). Sekretaria njofton studentët me anë të mail ose platformave elektronike. Vërehet që kjo pjesë nuk është e stabilizuar dhe po punohet për ta rivënë në përdorim dhe do jetë funksionale brenda sezonit të verës 2022 sipas vetë pohimit të përgjegjës të DKI.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Për këtë kriter rregullorja e UT dhe vetë stafi i programit të studimit pohon se studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim për vlerësimin e bërë. Ky sqarim kërkohet fillimisht tek pedagogu i lëndës ose komisioni i provimit në rastet kur nuk është dakord me të. Po kështu studentët shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut (lektorit të kursit), për të marrë sqarimet e duhura: pikët totale të vlerësimit së tezës dhe me pikët në çdo rubrikë. Kur ata nuk binden, kanë të drejtë t’i drejtohen me shkrim përgjegjës të departamentit që mbulon programin përkatës. Sa më sipër institucionalisht na pohohet se garantohet e drejta e studentit për t’u njohur me vlerësimin individualisht dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit (Dokumenti nr. I.8, Dokumenti nr. I.6, Dokumenti nr. I.20).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Kërkesat dhe ankimimet e studentëve shqyrtohen sipas rregullores së UT neni 51, Rregullores së Programit të Studimit KTU neni 35, sic edhe theksohet në RVB: brenda 24 orëve tek pedagogu i lëndës ose komisioni i provimit dhe kur nuk bindet për vlerësimin, atëherë brenda 48 orë nga marrja dijani e rezultatit të provimit, ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjës të departamentit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanatin. Ky ka kompetencën të ngrëjë komision <i>ad-hoc</i> i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Procedura e ndjekur është transparente dhe e rregullt (Dokumenti nr. I.8, Dokumenti nr. I.20).</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga dokumentat në dispozicion, konkretisht: Plani strategjik për zhvillimin e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” në DKI, del që Programi i studimit Bachelor në KTU zhvillohet në mënyrë të tillë që garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve, me qëllim orientimin e tyre praktik në fushën e teknologjive dhe analizave në industrinë ushqimore, që lidhen me sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve. Ky program studimi synon rritjen e kapaciteteve teorike dhe praktike të studentëve në fushën e kimisë dhe teknologjisë ushqimore. Ky Program për studentët, gjithashtu synon tu japë njohuri mbi përpunimin e informacionit (Dokumenti nr. I.16), dhe aftësi të prezantimit të dijeve në publik.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit KTU garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e Teknologjisë së informacionit komunikimit dhe ndërveprimit, dhe në lidhje me këtë përmban modulet e Informatikës, Bazat e teknikës laboratorike, Gjuhës së Huaj, dhe Edukimit fizik (Dokumenti I.9). Ai synon të zhvillojë aftësi në fushën e shkencave të ushqimit (Dokumenti nr. I.20). Programi ofrohet vetëm në gjuhën shqipe.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit vihet në dukje se: kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët në lëndë të ndryshme evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që përmban ky vlerësim. Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë (në orët e seminarit dhe seanceve të laboratorëve) dhe me shkrim në orët e kontrollit semestral të lëndës. Në syllabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në çdo lëndë të këtij programi studimi (Dokumenti nr. II.4).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Përgjegjësi i departamentit si edhe vetë stafi akademik i programit të studimit, theksojnë që në përfundim të lëndës, pedagogu bën edhe një përmbledhje për efekt orientimi dhe përsëritje të koncepteve/çështjeve kryesore të trajtuara. Ky kriter edhe nga studentët evidentohet si një ndihmesë për tu orientuar më mirë me modulin.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Duke parë dokumentacionin, ëbsite, takimi me dekanin, personelin akademik dhe studentët vihet re që FSHN e ka bërë traditë realizimin e orëve të hapura si veprimtari kurrikulare dhe ekstra kurrikulare. Kjo realizohet me lektorët e FSHN si edhe me lektorë të ftuar. Orët e hapura kanë në fokus zhvillimet më të reja të shkencës dhe teknologjisë me

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 41

	<p>tema specifike të cilat kanë interes për studentët dhe për publikun. Këto leksione të hapura shpallen në faqen zyrtare të FSHN në rubrikën njoftime. Në to ftohen profesorë të huaj ose të vendit që kanë akses me teknologjitë e reja inovative (Dokumenti nr. I.50).</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion shihet qartë se mësimdhënia në programin e studimit Bachelor KTU, kombinon formimin teorik me përvojën praktike dhe realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen, vizita tematike (Dokumenti nr. I.16). Në FSHN, DKI dhe konkretisht për PS KTU, ekziston dhe funksionon shumë mirë rrjeti i laboratoreve në funksion të rritjes së kompetencave të studentëve. <i>Mangësi që e kemi përmendur edhe në kriteret e tjera është mungesa e praktikave profesionale. Pavarësisht se në RVB theksohet që:</i></p> <p>Këto kryhen pranë institucioneve sipas profilit të përgatitjes së studentit (kimist teknolog ushqimor), pranë ndërmarje prodhimi të industrisë ushqimore, linja të përpunimit të lëndëve të para ushqimore, laboratore të vlerësimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.</p> <p>Praktikat ose vizitat zhvillohen në disa nga institucionet sipas të dhënave në tabelën nr 5 të aneks RVB me të cilat UT/FSHN, ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto aktivitete koordinohen dhe mbikqyren nga një pedagog i departamentit.</p> <p><i>Studentët pohojnë se vizitat nuk e zëvendësojnë praktikën profesionale dhe se në kushtet e pandemisë ju munguan jo vetëm praktikat profesionale por edhe labororet.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga diskutimi me personelin akademik të Departamentit të Kimisë Industriale del qartë se ata nxitin diskutimet dhe punën në grup gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve ku jepen ushtrime, probleme komplekse, detyra kursi, studentët diskutojnë, analizojnë, zgjedhin ose vlerësojnë mënyrat alternative të zgjidhjeve (Dokumenti nr. I.20). Këtë pohim e kanë edhe studentët të cilët e vlerësojnë komunikimin interaktiv dhe për të rritur frymën e bashkëpunimit, në realizimin e detyrave të kursit, gjatë orëve të leksionit, seminarit dhe laboratorëve.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Për këtë kriter personeli akademik i programit të studimit thekson se ata përpiqen maksimalisht për të krijuar një klimë sa më të përshtatshme për të angazhuar studentët në një debat interaktiv dhe për të rritur frymën e bashkëpunimit mes tyre. Në projektet dhe punën kërkimore të tyre ata inkurajojnë përfshirjen e studentëve për punë në grup, si edhe punën me literaturën bashkëkohore, simulimi i një situatë, ushtrime, etj.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Përgjegjësi i DKI dhe personeli akademik, pohojnë se ta nxitin idetë inovative të studentëve, në lidhje me teknologjitë e reja të prodhimit të produkteve industriale, duke ideuar apo projektuar, ose për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti (https://unitir.edu.al/bursa-shkembimi-Programi-erasmus/), në konferenca apo seminare studentore. Dekani i FSHN thekson se studentët janë integruar në punë kërkimore shkencore në departament, nën udhëheqjen e personelit akademik. Vetë FSHN organizon aktivitete të ndryshme në këtë drejtim, si dhe ofron mbështetje financiare, kjo edhe për Këshillat e Studentëve, veprimtaria e të cilëve në nivel fakulteti</p>

	mbështetet dhe financohet nga buxheti i fakultetit (Dokumenti I.2 Statuti i UT-së, Neni120, fq. 68 dhe Neni 136, fq. 72).			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga takimi me personelin akademik, ata pohojnë se në mësimdhënien e tyre i përfshijnë studentët në diskutime interaktive me qëllim që të promovojnë idetë dhe mendimin e tyre. FSHN ka organizuar disa konferenca dhe seminare studentore, si edhe shkolla verore. Sa më sipër i kanë shërbyer edhe Marrëveshjet në kuadër të programeve si Erasmus+, etj, të cilat konsistojnë në: Shkëmbimin e eksperiencës akademike; Mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus dhe Realizimin e praktikave, leksioneve të hapura, aplikim për projekte të përbashkëta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Ky program studimi bachelor përfundon me një provim final para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim. Ky komision ka 4 pedagogë. (përgjegjës për 4 modulet mbi të cilat mbështetet programi i provimit të formimit) [Dokumenti II.25 Programi për provimin e formimit në Bachelor Kimi dhe Teknologji Ushqimore ”, neni 40]. Sa më sipër është në përputhje me Detyrimet përmblyëse të programit Bachelor në KTU që realizohen me provimin final, “Provimi Formimi” (Dokumenti nr. I.9) dhe është përcaktuar me procedura të qarta në Rregulloret e UT (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e UT-së, Nenet: 59-61, fq. 31-32), Rregullore e Departamentit Kimi Industriale (Dokumenti nr. I.6), Rregulloren e Programit të studimit KTU (Dokumenti nr. I.20), Rregullorja e Diplomimit (Dokumenti nr. II.4). Siç pohohet nga stafi akademik këtij programi studimi procedura e mësipërme ju behet e ditur studentëve dhe publikohet në ëbsite e FSHN. Studentët mund të njihen me të nëpërmjet faqes elektronike të departamentit (Dokumenti nr. II.4, Dokumenti nr. I.41).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Stafi akademik pohon se në prag të diplomimit ata ju japin studentëve sqarimet e nevojshme nëpërmjet këshilltarit akademik (Dokumenti nr. I.35), sekretarisë mësimore dhe drejtuesit të departamentit. Ata zhvillojnë takime informuese, në lidhje me provimin final. procesin e diplomimit. që realizohet për studentët e vitit të fundit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final	Nga takimi me përgjegjësën e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit pohohet se Komisioni i posaçëm për provimin final



<p>bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>në bazë të rregullores përbëhet nga pedagogë të departamentit, të lëndëve që mbulon programi i provimit. Komisioni harton tezën për provimin final referuar njohurive të përfuara nga studentët në tre vite akademike, mbi bazën e programit të provimit të formimit të shpallura më herët për studentët. Janë përzgjedhur katër module që zhvillohen kryesisht në vit të dytë dhe të tretë: modulet e lëndëve të Teknologjisë Ushqimore, Mikrobiologjisë Ushqimore, Bazat e transmetimit të nxehtësisë e masës; dhe Kontrolli proceseve në inxhinieri ushqimore. Secili modul zë 25% të vlerësimit përfundimtar. Pyetjet janë formuluar të përzjera: me shtjellim dhe me alternativa (Dokumenti nr. I.41).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Personeli akademik i PS pohon se orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbylljes së programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore; në respektim të Rregullores së Programit të studimit (Dokumenti I.20).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dispozicion si edhe nga përgjegjësi i DKI, pohohet se procedura e vlerësimit të provimit të diplomës bazohet në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloren e Diplomimit (Dokumenti nr. I.20, Dokumenti nr. II.4). Në përfundim të provimit të formimit i cili organizohet me shkrim ose me gojë, studenti vlerësohet me notë, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga pesë deri në dhjetë janë kaluese. Vlerësimi bëhet publik në fund të zhvillimit të provimit dhe ju komunikohet studentëve (Dokumenti I.20 Rregullore e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, neni 40). Ky vlerësim pasqyrohet në procesverbalin e firmosur nga anëtarët e komisionit dhe që depozitohet në sekretarinë mësimore (Dokumenti nr. III.31).</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e</p>	<p>Përgjegjësi i DKI bën me dije për këtë kriter se: në përfundim të programit të studimit, kur studenti i ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, pajiset me diplomën Bachelor “Kimi dhe</p>

<p>diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Teknologji Ushqimore” dhe suplementin e saj, të miratuara nga MAS. dhe të firmosur nga Dekani dhe Rektori i Universitetit të Tiranës (Dokumenti I.2, Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 110, fq. 64, Dokumenti I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 63, fq. 32-33, Dokumenti nr. I.20). Diplomat shoqërohen me suplementin (Dokumenti I.8, Rregullore e UT-së, Neni 61, fq. 32 dhe Neni 63, fq. 32) që përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Diploma nënshkruhet nga dekani i njësisë kryesore dhe Rektori i UT. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UT (Dokumenti nr. II.5, Dokumenti nr. II.6).</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në Rregulloren e programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, thuhet që: pas diplomimit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse (Dokumenti nr. I.20). Në RVB gjithashtu thuhet që: në rast se studentit i nevojitet një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, studenti merr formularin për program tek sekretaria mësimore, bën pagesën në çdo bankë të nivelit të dytë, dhe më pas tërheq programin e firmosur dhe të vulosur nga Rektori pranë sekretarisë së fakultetit/ departamentit brenda një periudhë kohore prej 10 ditësh. Tarifa e pajisjes me programin përcaktohet me vendim senati.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Përgjegjësi i DKI na informon në lidhje me këtë që: Bazuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës (Dokumenti nr. I.8, Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 64, fq. 33). Institucioni ka për detyrë të mbajë në formë të shkruar dhe elektronike: regjistrin themeltar (Dokumenti nr. III.32); regjistrin e arritjeve akademike (Dokumenti nr. III.33); regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave (Dokumenti nr. III.34). Regjistrat depozitohen në arkivat e shtetit, (sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat), ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të regjistrimit të tij arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Sa më sipër i verifikua si dokumentacion në zyrat përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, Universiteti i Tiranës mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ai ofron. Në FSHN, është Dega e Burimeve Njerëzore ajo e cila është përgjegjëse për mbledhjen, ruatjen dhe përditësimin e dhënave të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Sipas procedurës të përshkruar në GVB, çdo fillim viti akademik përcaktohet stafi akademik dhe ngarkesa individuale semestrale dhe vjetore e çdo personeli akademik të angazhuar në mësimdhënien e programit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” (dokumenti nr. 4.3 paraqet ngarkesën për cdo antarë staf akademik të DKI dhe 1.16). Departamenti i Kimisë Industriale, kaq në përbërje të tij, gjithësej 19 staf akademik me kohë të plotë ku: 3 janë me titull Prof.As., 4 janë me titull Prof. Asoc.Dr., 10 janë me titull Dr dhe 2 janë me titull M.Sc. 11 janë staf akademik me kontratë ndër të cilët: 2 janë me titull Prof.As., 2 janë me titull Prof. Asoc.Dr., 4 janë me titull Dr dhe 3 janë me titull M.Sc. (dokumenti nr. 1.16). Gjithashtu shefi i departamentit, në bazë të kompetencave që i jep Statuti i UT, (dokumenti nr. 1.2) dhe Rregulloja e UT (dokumenti nr. 1.8) mbikqyr veprimtarinë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit, drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre. Sipas raportit të GVB, FSHN, realizon vlerësim të punës së personelit akademik sipas rregulloreve përkatëse. Në formularin e vlerësimit janë të përfshira disa kategori si konteksti i punës, objektivat dhe matësit e performancës, sjellja profesionale etj. (dokumenti nr. 6.19). Cv e stafit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ndihmës akademik janë të përditësuara dhe të paraqitura me dokumentin nr. 1.24, 1.26, 1.28.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, punësimi në UT, realizohet me konkurs të hapur, transparent, vlerësim objektiv dhe të paanshëm.</p> <p>Duke u bazuar në Statutin e UT (dokumenti nr. 1.2) dhe “Manualin mbi punësimin e personelit në UT”, (dokumenti nr. 1.39, miratuar dt 24.01.2022) institucioni realizon procedurën e punësimit, ku Drejtuesit e institucionit kanë për detyrë zbatimin e procedurave si</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ përcaktimi i kriterëve të veçanta, ✓ shpallja e vendeve vakante, ✓ krijimi i komisionit <i>Ad hoc</i>, ✓ shpallja e fituesit dhe ✓ procedura e ankimimit (dokumenti nr. 1.8, Rregullore e UT)

	Në lidhje më rekrutimin e personelit akademik ndiqet procedura e shqalljes së ofertës së punës në faqen e internetit të Fakultetit ose në Buletinin e njoftimeve publike (me kërkesat e përgjithshme dhe specifike, në varësi të pozicionit vacantë të punës e miratuar dhe e firmosur nga titullari I institucionit. (dokumenti nr. 1.38 paraet një shembull kriteresh për pozicion vacant për asistent lector në DKI).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në raportin e GVB, thuhet se kriteret e përgjithshme dhe te vecanta për rekrutimin e personelit akademik propozohen nga departmenti përkatës në bazë të soecifikave dhe nevojave që ai ka. Pasi Dekani kryen verifikimet përkatëse, percjell shkresën në Rektorat i cili ndjek procedurën e përgjithshme sipas Statutit të UT. (Dokumenti nr. 1.2 dhe 1.38).			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Sipas raportit të RVB, procedura e rekrutimit dhe vleresimit për kantitatët që kanë aplikuar në vendet vakante, bazuar në statutin e UT, rregulloren e UT dhe Manualin e punësi në UT (dokumenti nr. 1.2, 1.8 dhe 1.39) është si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Dekani krijon komisionin <i>Ad-hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë ku anëtari i komisionit me titullin akademik më të lartë dhe me përvojën akademike më të vjetër nga radhët e departamentit, caktohet kryesuesi i komisionit ✓ Komisioni i ngritur në bazë të dokumentacionit të paraqitur kryen verifikimin paraprak të kandidatëve që pëmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, në bazë të kriterëve të paraqitura në shpalljen e vendit vakant, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të dosjeve. Vlerësimi i kandidatëve realizohet me anë të dy fazave të njëpasnjëshme; <ul style="list-style-type: none"> ✓ vlerësimi i dosjes dhe ✓ intervista, për kandidatët që e kanë kaluar fazën e parë Komisioni shpall kandidatin fitues brenda 3 ditëve pune nga data e zhvillimit të intervistës ku fituesi gjithashtu publikohet edhe në faqen e fakultetit të FSHN-së. Rektori i Universiteti të Tiranës pas paraqitjes së kandidatit fitues nga komisioni <i>Ad-hoc</i> nënshkruan kontratën e punës me fituesin. Shembuj të krijimit të komisionit dhe të procedurës së aplikimit janë të evidentuara në dukumentin me nr 1.38.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të

Bazuar në RVB, personeli akademik i cili është i angazhuar në këtë program studimi ka hapësirat e nevojshme për të zhvilluar detyrat e tyre në mënyrë profesionale.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47

<p>barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Ky staf akademik realizon detyrat e tij, ne godinat A, B, C dhe D të cilat janë godina shumë vjecare por me një infrastrukturë shumë të mirë dhe të mirëmbajtura rregullisht. Sallat të cilat shfrytëzohen për zhvillimin e procesit mësimor për Programin e Studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” në pjesën më të madhe zhvillohet në ambientet e godinës A, të FSHN. Aty gjenden laboratorët të cilët përdoren për shumë programe studimi, ndër të cilët dhe programi në fjalë. Disa nga laboratorët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kimisë të Përgjithshme dhe Inorganike, ✓ të Kimisë Organike, ✓ Kimisë Fizike dhe Koloidale, ✓ Kimisë Analitike; ✓ Laboratorët e Kimisë e Teknologjisë Ushqimore, ✓ të Proceseve dhe impianteve në inxhinierinë Kimike, ✓ Mikrobiologjisë Ushqimore <p>Të gjithë këto laboratorë janë paraqitur dhe në dokumentin nr. 1.22, ku janë specifikuar dhe sipërfaqet përkatëse me një standart afërsisht rreth 47 m² për laborator. Për zhvillimin e punës për personelin akademik janë vënë në dispozicion, në nivel departamenti rreth 10 salla me sipërfaqe nga 15-47.6 m² (Salla 111A me sip.14.9 m² Salla 110A me sip. 47.6 m², Salla 109A me sip. 47.6 m², Salla 108A me sip.14.9 m², Salla 103A me sip.15 m² Salla 102A me sip. 28.5 m², Salla 119A me sip. 25.1 m², Salla 217A me sip. 25.2 m²) (dokumentin nr 1.18 tregon të dhëna të tjera më të hollësishme në lidhje me infrasktururën e DKI/FSHN).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të raporti të RVB, personeli akademik që është i përfshirë në programin e studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore zotëron kualifikimin e duhur. Stafi i departamentit DKI që ofron edhe Programin e Studimit Bachelor KTU përbëhet nga 19 personel akademik të kategorisë PAE nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ 3 me titull Prof.Dr. ✓ 4 me titull Prof. Asc. Dr. ✓ 10 me gradën Dr., ✓ 2 Msc. <p>Gjithashtu në këtë program janë të angazhuar në mësimdhënie edhe pedagogë nga seksione të tjera të departamentit, si nga grupi mësimor kërkimor i Inxhinierisë së Proceseve Kimike (janë të angazhuar pedagogë, nga të cilët 3 janë me titull Dr. dhe një pedagog me titull Prof. Asoc.) apo edhe pedagogë nga departamente të tjera.</p> <p>Përsa i përket kualifikimit të vazhdueshëm, stafi i angazhuar në këtë program studimi, është përfshirë në projekte dhe veprimtari shkencore, realizojnë kualifikime dhe specializime në varësi të fushave specifike të tyre, duke rritur në këtë mënyrë cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Disa nga projektet ku janë të përfshirë ky staf akademik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Erasmus-KA107 (Marrëveshjet ERASMUS + KA107 të nënshkruara nga Universiteti i Tiranës).

	<p>✓ Erasmus+ (NETCHEM) (dokumenti nr 1.45, 1.42 2.24 etj, ku tregohet përfshirja e stafit në këtë projekt).</p> <p>✓ Projekt NanoAlb etj.</p> <p>FSHN ofron mbështetje financiare për stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca apo publikime në revista shkencore. (dokumenti nr. 1.48, 2.24, 4.11 etj.).</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sipas RVB, UT ka hartuar Udhëzuesin për Programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”. Nëpërmjet këtij programi UT synon të mbështesë Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë në fushat e kërkimit dhe të inovacionit. Stafit akademik është trajnuar gjithashtu edhe nga IT e FSHN dhe e UT për 2 metodat e mësimdhënies në distancë dhe për mënyrën e organizimit të provimeve online: Google Classroom dhe Microsoft Teams. (dokumenti nr 3.30, 4.12, 5.16).</p> <p>Në faqen e internetit të FSHN, është ngarkuar një udhëzues për staf dhe student për mësimdhënien e mësimin në distancë ku shpjegohet menyra e zhvillimit të provimit online dhe përdorimi i platformës dixhitale. (dokumenti nr. 3.3, 3.4, 5.22).</p> <p>Institucioni ofron dhe mbështetje financiare për stafin akademik të cilët dëshirojnë të trajnohen për metodat inovative të mësimdhënies. (dokumenti nr. 4.13 tregon kërkesën e Dr. Xhaklina Cani, për pjesëmarrje në trajnim në Graz , Austri për IPSE pro Spring Training 25-27 Prill 2018). Ofrimi i leksioneve të hapura janë një tjetër mundësi e rritjeve të kapaciteteve profesionale të stafit akademik. (dokumenti nr. 1.50).</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UT, i cili ofron këtë program studimi, kryen veprimtari monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi të cilësisë së personelit akademik nëpërmjet drejtuesit të njësisë bazë (dokumenti nr. 4.3).</p> <p>Në bazë të dokumentave të dorëzuar nga GVB, duke qartë se stafi akademik efektiv dhe me kontratë është kompetent për lëndët që mbulon (dokumenti nr. 1.24, 1.28). Shumë prej stafit janë të angazhuar në komisione në institucione të ndryshme shtetërore dhe private, gjë që tregon kompetencat e këtij stafi akademik dhe me kontratë të jetë kompetent në fushën e tyre përkatëse. (dokumenti nr. 4.14, 4.15).</p> <p>Për plotësim të nevojave dhe mbështetje mësimore, në këtë program studimi është angazhuar dhe dhe sekretaria mësimore dhe stafi administrative në FSHN (dokumenti nr. 1.23).</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të</p>	<p>Sipas RVB, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ku ky program siguron mjediset për të realizuar veprimtarinë mësimdhënëse, ka vënë në</p>

<p>përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>dispozicion salla leksioni, klasa seminari dhe laboratorë (dokumenti nr. 1.18, 2.2).</p> <p>Godinat të cilat përdoren për këtë program janë</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Godina A me 3 salla leksionesh dhe 7 klasa seminari, sip tot 691.42 m². ✓ Godina B me 3 salla leksioni dhe 1 klase seminari, sip tot 288.6 m². ✓ Godina C me 6 salla leksioni dhe 1 klase seminari, sip tot 444.08 m². ✓ Godina D me 6 salla leksioni, sip tot 1107.3 m². <p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore janë laboratorët</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Laborator mësimor i Teknologjisë ushqimore për lëndët Kimi dhe Teknologji Ushqimore I dhe II, sip.47.6 m². Laborator mësimor i Mikrobiologjisë Ushqimore për lëndët Mikrobiologji I dhe II me sip.47.6 m² ✓ Laboratori mësimor i Inxhinierise Kimike I, për lëndën e Procese dhe Impiante në Inxhinieri Kimike me 40.1 m². ✓ Laboratori mësimor i Inxhinierise Kimike II, për lëndën e Kontroll i Proceseve në Inxhinieri Kimike. <p>Për zhvillimin e plotë të programit të studimit, në dispozicion të studentëve të këtij programi janë vënë në dispozicion dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Laboratori mësimor i Kimisë së Përgjithshme e Inorganike, Laborator mësimor i Kimisë Organike për lëndët e Kimisë Organike Laborator mësimor i Analizës Organike + Preparator për lëndët e Kimisë Organike. ✓ Laborator mësimor i Kimisë Analitike + një Preparator Laboratori mësimor i Kimisë Fizike dhe Koloidale. ✓ Laboratori mësimor Fizike (dokumenti nr. 1.18, 2.2). <p>Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura kryesisht me tavolina dhe karrige me kapacitet pothuaj në përputhje me numrin e studenteve, dërrasë të zezë për shkumësa ose <i>Ëhite board</i> per lapustil, priza elektrike për përdorimin të laptopit dhe videoprojektorit, perde video projektimi etj.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Për sa i përket infrastrukturës, të vënë në dispozicion për këtë program studimi, ashtu si u përmend dhe më lart, godinat janë shumëvjeçare, por janë të mirëmbajtura dhe plotësojnë kushtet për zhvillimin sa më të mirë të mësimin. Disa prej sallave të leksioneve në Godinën A, B dhe D janë të pajisura me kondicioner, ndërsa në sallat e Godinave A dhe C janë të instaluar sistemi i ngrohjes qendrore që funksionon në stinën e dimrit. Për zhvillimin sa më të mirë të mësimin, janë vënë në dispozicion për stafin të angazhuar në këtë program studimi, videoprojektorë portabël.</p> <p>Ndërkohë në sallat e mëdha të leksioneve, janë të instaluar mjetet audio vizive (dokumenti nr. 3.41).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit,</p>	<p>Për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve që janë pjesë e këtij programi studimi, janë vënë në dispozicion laboratorë me pajisje bashkëkohore. (dokumenti nr. 3.13).</p>

përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Duke qenë se në laboratorë punohet me metodika të standartizuara, ato janë vënë në shërbim të analizave fiziko-kimike në kuadër projektesh, doktoraturash, diplomash si dhe analiza të kërkuara nga të tretë (dokumenti nr. 4.36). Sipas buxhetit të FSHN për vitet 2019-2021, një shumë e konsiderueshme ka kaluar për përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të cilat përdoren jo vetëm nga stafi për të kryer kërkimin shkencor por dhe nga studentët për punë laboratorike apo tema diplome (dokumenti nr. 4.17).			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga RVB, në departament ndodhet edhe një sallë laboratorij 'Laboratori i Simulim Modelimit' (salla 113A, sip.92.2 m ²) 800 i cili është me pajisur me 24 poste pune me kompjutera. Kjo sallë së fundmi është pajisur me kompjutera të rinj dhe me impiante pilot të proceseve të ndryshme në inxhinierinë kimike. Vlera e këtij laboratorij qëndron në softuerët e instaluar, simulatorët në ndihmë të disa kurseve specifike. Programet e instaluar janë: Paketa Microsoft Office, Aspen Plus/Hysys, Design II, MATLAB, Super Pro/Designer, LINGO. Duke qenë pjesë e projektit NETCHEM (dokumenti nr. 1.45) është mundësuar në grupin e Kimisë Analitike një sallë për edukimin në distancë ku edhe Departamenti i Kimisë Industriale ku bën pjesë ky program studimi, i është ofruar akses (dokumenti nr. 1.42).			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Për të vërtetuar kapacitetet që janë vënë në dispozicion për këtë program studimi nga institucioni, GVB shprehet se ka 24 laboratorë të cilët përdoren për realizimin e aspektit praktik, në lëndët: Kontrolli dhe Automatizimi i Proceseve, Inxhinierinë Kimike, Kimi dhe Teknologji Ushqimore I dhe II, Mikrobiologji I dhe II (dokumenti nr. 1.18). Për zhvillimin e praktikave mësimore, institucioni bashkëpunon me kompani të ndryshme si Kantina e Pijeve " Gjergj Kastrioti", marrëveshje e nënshkruar në 21.06.2021, Kompania Lufra, marrëveshje e nënshkruar më 11.11.2019 etj (dokumenti nr. 1.16 dhe 1.46).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Sipas raportit të GVB, për të rritur nivelin e mësim dhënies dhe mësim nxënies të studentëve dhe stafit, Universiteti i Tiranës ka vënë në dispozicion Bibliotekën qendrore dhe atë të FSHN.
Në **dokumentin 1.2**, Statuti i UT, janë të përcaktuara dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Bibliotekës Qendrore të UT.
Biblioteka e FSHN funksionon në bazë të "Rregullores së Brendshme të Bibliotekës" së Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 51

	<p><i>Tiranës, dokumenti nr. 4.18, e cila ka literaturë të printuar dhe online dhe është e aksesueshme nga të gjithë studentët e studimeve Bachelor dhe Master të të gjitha degëve, nga personeli akademik dhe kërkues shkencorë. Biblioteka ka katër ambjente të ndara në 3 salla leximi (fondi i hapur i librit, fondi i hapur periodik, dhe fondi kryesor me banak) me 140 poste studimi (dokumenti nr. 1.22).</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas GVB, biblioteka e FSHN, përmban mbi 80000 njësi libra, dispenca e disertacione dhe mbi 15000 njësi periodiku.</p> <p>Biblioteka ka një listë të teksteve dhe të literaturës bazë të lëndëve, të cilët studentët mund ti shfrytëzojnë.</p> <p>Biblioteka e FSHN ka në përbërjen e saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri total i titujve shkencorë (libra dhe monografi shkencore) janë 36520 njësi nga të cilat 1146 shqip dhe 35374 në gjuhë të huaj. • Numri total i monografive është 12185 (427 shqip dhe 11758 në gjuhë të huaj). • Numri total i revistave periodikë shkencorë është 24441 njësi (64 shqip dhe 24377 në gjuhë të huaj). • Për periudhën 2008-2021, janë të përfshira dhe 67 tituj doktoraturash. <p>Në varësi të nevojave, fondi pasurohet më tituj te rinj në vaësi të nevojave nga departamenti.</p> <p>Në biblioteka sipas dokumentit nr. 2.3, janë vënë në dispozicion për studentët dhe textet mësimore për modulet e programeve të studimit përfshirë dhe programin e studimit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas GVB dhe dokumentit nr. 4.19, UT në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për zhvillim (AADF) ka finalizuar marrëveshjen për abonim në bibliotekën digjitale JSTOR, ku aksesimi online në bibliotekën dixhitale JSTOR mund të bëhet edhe me anë të e-mailit personal zyrtar. Ky fond është i aksesueshëm edhe për studentët e Programit të studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore.</p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga RVB, Biblioteka e FSHN-së ofron gjithashtu informacione dhe materiale në formë elektronike nga burime online (Biblioteka online MARS dhe COBISS dhe nga platformat online (Edgar, IOP, ASTM, MPS).</p> <p>Ajo mundëson përdorimin falas të katër burimeve online: (dokumenti nr. 1.16).</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ASTM International, ASTM Compass abstract & non-standards content, 1 Janar-31 Dhjetor 2022. 2. Edëard Elgar Journals, 1 Janar-31 Dhjetor 2022. 3. IOP Science, 1 Janar-31 Dhjetor 2022. 4. MSP Journals, 12 Nëntor 2019 -31 Dhjetor 2022.
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë</p>	<p>Sipas RVB, në dispozicion të studentëve janë vënë katër kompjutera në akses në internet, ndërsa studentët e DKI, mund të përdorin dhe kompjuterat në sallën e DKI, të dhëna të paraqitura dhe në dokumentin nr. 1.18, mbi infrastrukturën e DKI</p>

shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<i>Do të ishte e nevojshme që për një numër të madh studentësh të cilët janë pjesë e FSHN dhe e DK, të vendoseshin në dispozicion një numër më i madh pajisjesh kompjuterike ku ato të aksesojnë materialet online.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Për pasurimin e fondit të bibliotekes së FSHN, UT, sipas GVB dhe dokumentit të vënë në dispozicion prej saj, ka një fond të vecantë në buxhetet e viteve 2019-2021 për blerje fond libri, libra, abonime në bibliotekat elektronike dhe revistat periodike dhe është përcaktuar financimi i nevojshëm për blerjen e literaturës bashkëkohore dhe specifike për programet e studimit.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sipas GVB, biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të enjte, 08.00-16.30 dhe ditën e premte 08.00-14.00, orar zyrtar për administratën. Ajo ofron shërbim të saj për studentët dhe stafin e FSHN. Për orare të tjera, jashtë atij zyrtar, studentët dhe stafi kanë aksesin online 24 orë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas GVB, FSHN disponon një sistem të brendshëm për administrimin e informacionit të rregjistrimit të studentëve deri në diplomim. Sipas dokumentave të dorëzuar nr 3.32, 3.33, 3.34 sekretaria mësimore e FSHN mban në formë të shkruar rregjistrin themeltar të studentëve, atë me të dhëna akademike dhe rregjistrin e lëshimit të diplomave. Gjithashtu ajo arkivon: Dosjet e regjistrimit të studentëve, Procesverbalet e provimeve, Dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor, Dosjet e programeve/ lëndëve të ekuivalentuara për kategoritë transferim dhe degë të dyta të studimit, Statistikat e studentëve frekuentues, Statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit, Statistikat e studentëve që ç'rregjistrohen, Dosjet e diplomimit sipas dokumentave (dokument nr. 3.31, 1.31, 4.35 etj.). Nëpërmjet platformës e-Student (dokumenti nr. 4.23) studentët marrin informacion në lidhje me: Departamentin, planet mësimore, lëndët dhe modulet, grupet mësimore, listat e notave, hapja e sezoneve të provimeve, rregjistrimin në provime dhe historikun e regjistrimeve në provime. Cdo student dhe staf ka email e tij zyrtar me domain fshn.edu.al dhe unitir.edu.al për stafin, fshnstudent.info dhe unitir.edu.al për studentët. Këto adresa janë të aksesueshme dhe pas mbarimit të studimeve.

	DKI, si njësi bazë që ofron këtë program studimi, përdor keto adresa elektronike dhe platformën digjitale për tu ofruar studentëve informacione që ndjekin programet e studimit që ofron departamenti, informacione më të detajuara dhe të përditësuara për zhvillimin e procesit mësimor.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit	Sipas GVB, FSHN disponon Sistemin Informatik (dokumenti nr. 4.24) i cili transmeton informacione të ndryshme përmes implementimit të sistemeve menaxhuese të informacionit arsimor, rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit të Universitetit të Tiranës. Për sa i përket aktivitetit shkencor dhe kërkues, të personelit akademik, përgjegjësi i departamentit grumbullon informacione nevojshëm dhe e paraqet atë ne Raportin vjetor të FSHN. (dokumenti nr. 1.42).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas GVB, sistemi i menaxhimit të informacionit që zotëron FSHN, është diskret dhe ruan të dhënat personale të studentëve dhe të stafit të saj. Ato janë përshkruan dhe në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës”, të emërtuar me document nr 4.27 . Këtë sistem e akseson cdo kush që ka një llogari në të dhe studenti gjen informacione mbi planet mësimore, sezonin e provimeve etj ndërsa stafi akademik menaxhon të dhënat personale, kontrollon grupet mësimore, hedh notat, kontrollon kërkesat për përmirësim note, ankimim etj. (dokumenti nr 5.23).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sipas GVB, për komunikimin midis stafit akademik dhe studentëve përdoren adresat e email të përmenduar më sipër dhe dy platformat Google Classroom, Microsoft Office 365. Në dokumentin nr. 3.18 ka shembuj të ngarkimit të leksioneve “ Përpunimi i mbetjeve ne IU”, nga pedagogët dhe komunikim me studentët. Për informacione të përgjithshme studentët përdorin dhe faqet e internetit të UT/FSHN/DKI.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sipas GVB, në ambientet e FSHN funksionon zyra e IT, e cila adreson dhe zgjidh në kohë reale problematikat e ndryshme të studentëve dhe stafit akademik në lidhje me problematikat e tyre. Sistemi i brendshëm i FSHN përmban llogari të stafit akademik, ndihmës akademik dhe sekretarisë mësimore. Sistemi, platform digjitale MS teams dhe faqet zyrtare te IAL përditesohet me të gjithë informacionet e nevojshme për të mundësuar raportimet individuale mbi aktivitetin akademik. (dokumenti nr. 4.22).
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sipas RVB, informacione të detajuara mbi të gjitha programet e studimit që ofron IAL, ku ben pjese dhe programi Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, janë të publikuara në faqen zyrtare të FSHN. Në të gjenden informacione mbi stafin akademik dhe aktivitetin e tyre, programet akademike që ofron departamenti, për çdo program, objektivat e programit të studimit, planin mësimor, syllabysset e lëndëve të programit. Sekretaria, oraret, kërkimi shkencor, buletini shkencor, bazat ligjore apo dhe njoftime për aplikime bursash.

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas GVB, IAL në mënyrë periodike përgatit Raportin Financiar i cili miratohet pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Admistrimit.</p> <p>Cdo informacion apo raport financiar publikohet në faqen zyrtare të Institucionit dhe janë të aksesueshme nga të gjithë, në bazë të dokumentit nr 4.29 mbi "Miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT". Sipas RVB, FSHN publikon buxhetin e tij në faqen zyrtare të internetit, i cili pasqyron planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Shembuj të buxheteve dhe publikimeve janë në dokumentin nr 4.8, 4.9, 4.10.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas RVB, UT harton një plan buxhetor afatmesëm që përditësohet çdo vit, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të universitetit. Administrata financiare e Universitetit, harton projektbuxhetin e njësive të tjera ndihmëse dhe bashkë me projektbuxhetet e njësive kryesore, harton dhe projektbuxhetin e UT për vitin respektiv. Sipas dokumentit nr. 4.31, cdo vit departamentet paraqesin në dekanat kërkesat e tyre për vitin e ri akademik.</p> <p>Për të qenë transparent, FSHN publikon në eëbsite e saj zyrtar buxhetin vjetor të universitetit të Tiranës ku miratohen: Detajet e kuotave të konsoliduara, detajet e shpenzimeve operative, detajet e investimeve, numrin të planifikuar të punonjësve (dokumenti nr. 4.8, 4.9, 4.10).</p> <p>Në buxhet në tabelat përkatëse janë të paraqitura të gjitha financimet e realizuara për FSHN, si; (vlerat e kontratave të realizuara për objektet e fakultetit, detajim i shpenzimeve korrente operative, materiale zyre të përgjithshme, materiale dhe shërbime speciale, abonime në biblioteka elektronike ndërkombëtare për botime të ndryshme (Ebsco, Jstore, etj), rimbursim publikimesh shërbime nga të tretë, shpenzime transporti, shpenzime udhëtimi brenda e jashtë vendit, qeremarrje, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale, mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime të tjera të papaguara (dokumenti nr. 1.16). Për realizimin e programit të studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore" institucioni ka vendosur në dispozicion të gjitha burimet njerëzore për realizimin e tij. Sipas dokumentacionit të dorëzuar stafi akademik mbështet nga institucioni duke financuar pjesmarrjen e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitet ndërkombëtare.</p> <p>(https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/info/:publications)</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB, thuhet se UT/FSHN është audituar ndër vite nga auditimi i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga njësi e auditimit të brendshëm të UT. Në strukturën e UT, sipas dokumenti nr. 4.2, bën pjesë Dega e Auditit, e cila në zbatim të programeve të punës, për fushat me risk më të lartë, planifikon plane auditimi, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.</p> <p>Raporti i veprimtarisë financiare të paraqitura në kuadër të programit të transparencës, paraqitur në dokumentin nr. 4.29, diskutohet me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Bordin e Administrimit dhe në Senatin Akademik. Ky raport është transparent dhe informacioni jepet për të gjithë personelin apo studentët e interesuar.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas RVB, dhe dokumentit nr. 4.34 raportet financiare të hartuara në IAL, ofrojnë informacion mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim.</p> <p>Në bazë të dokumentit nr. 4.33, vërtetohet se Institucioni harton çdo vit projekt buxhete afatmesme, të cilat janë të detajuara në bazë të kërkesave të Fakultetit si dhe në përmbushjen e qëllimit, misionit dhe vizionit të UT-së.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB, IAL e cila ofron programin e studimit Bachelor” Kimi dhe Teknologji Ushqimore” në bazë të të ardhurave të veta (tarifa shkollimi, tarifa regjistrimi), grantit të përcjellë nga Ministria e Arsimit, Rinisë e Sportit, të ardhurave nga shërbime që ofron institucioni, garanton qëndrueshmërinë financiare gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave për të ardhmen. Po sipas RVB dhe dokumentit nr. 4.34, çdo vit miraton buxhetin përfundimtar, mbështetur në kërkesat buxhetore të fakulteteve me qëllim arritjen e objektivave strategjike si dhe për realizimin e misionit të tij. (dokumenti nr. 4.8, 4.9, 4.10, të cilët paraqesin buxhetin e FSHN).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE



Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Sipas RVB, UT/FSHN kanë hartuar disa rregullore të cilat ndihmojnë dhe mbulojnë çdo aspekt të jetës studentore.</p> <p>Programi Bachelor Kimi dhe Teknologji Ushqimore, ofrohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë mbi politikat studentore. (Ligji Nr. 80/2015). Sipas Statutit të UT dhe Rregullores të programit të studimit, e evidentuar në dokumentin nr. 1.20, në pjesën e katërt të tij, përcaktohen kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve.</p> <p>Në bazë të Statutit të UT dhe Rregullosës së UT, dokumenti nr. 1.2 dhe nr. 1.8, përcaktohet pranimi i studentëve të rinj për çdo vit akademik si dhe procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Regjistrimi i studentëve bëhet pranë sekretarisë mësimore (dokumenti nr. 4.21), kur ata paraqesin dokumentacionin përkatës sipas udhëzimit të përvitshëm të MAS. Sipas dokumentit nr. 1.20, “Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, parashikohen të gjitha kërkesat për ndjekjen e programit, procedurën e diplomimit si dhe elementët mësimorë të programit. Statuti i Universitetit të Tiranës përcakton gjithashtu edhe detyrat e Kujdestarit Akademik (dokumenti nr. 1.35), që i orienton studentët me hyrjen në program.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, është hartuar dhe në bazë të Rregullosës së Universitetit të Tiranës, duke marrë parasysh lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe studentëve. Në këtë mënyrë ky program siguron të drejta të plota për të gjithë studentët e UT. Sipas rregullosës së programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, dokumenti nr. 1.20, në faqen 17-18 janë përcaktuar të drejtat e studentit si: Të marrin informacion nga Kujdestari akademik, të kenë llogaritë e tyre personale në FSHN/UT dhe nëpërmjet këtyre adresave studentëve u mundësohet aksesimi në platformën Microsoft Teams, të kandidojnë për në Këshillat studentor, këshillat e Studentëve, promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e UT-së dhe njëjësive kryesore, të marrin pjesë në aktivitetet shkencore dhe sociale, që organizon UT/FSHN, të aplikojnë për bursa studimi dhe reduktim të Tarifës, të aplikojnë për bursa Erasmus apo bursa të tjera Mobiliteti, të ankimojnë vlerësimin në provime, për këshillimin me psikologun e FSHN, për pjesëmarrjen në aktivitete sportive brenda dhe jashtë universitetit, për informim në faqen elektronike të FSHN etj. Të gjitha këto të drejta të përmendura më sipër janë të dokumentuara në dokumentët të vënë në dispozicion për GVJ.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë</p>	<p>Sipas GVB, objektivat e këtij programi studimi janë të qarta dhe janë paraqitur dhe në dokumentin 1.1 Statuti I UT. Në dokumentin nr. 1.34, dhe nr. 2.12 janë paraqitur qartë kriteret e pranimit të studentëve në këtë</p>

<p>kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>program studimi. Në dokumentin nr. 5.3 është paraqitur procedura e pranimeve të reja në UT/FSHN/DKI. Gjithashtu të dhëna të tjera të vëna në dispozicion, në dokumentin nr. 1.37, tregojnë komisionet për transferim dege apo dokumenti nr. 5.4 vlerësimin dhe diplomimin. Të gjitha këto të përmendura më sipër janë të dokumentuara dhe në Rregulloren e programit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” dhe rregulloren e UT si dhe në fjalë më të kuptueshme për të gjithë në faqen e internetit të UT dhe FSHN.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, dhe dokumentit nr. 2.12, DKI përgatit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve që do të pranohen, jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit paraardhës kalendarik (bazuar dhe ne Statutin e UT, dokumenti nr. 1.2), si dhe Udhëzimit të MA mbi Rregjistrimin e Studentëve në programet e ciklit I të studimeve, për të gjitha programet e studimit që ofron, kjo në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe ia dërgon ato fakulteti. Kriteret i përcillen rektoratit i cili ka për detyrë t’ia përcjellë MAS. Sipas dokumentit nr. 1.33, departamenti përcakton edhe kuotat, në të cilat parashikon përfshirjen edhe të kandidatëve nga trojet dhe nga shtresat e margjinalizuara. Kriteret dhe kuotat miratohen në Senatin Akademik të UT, e dërgohen në MAS dhe publikohen në portalin https://ualbania.al. Në dokumentin nr. 5.6 është treguar Vendimi i Senatit për miratimin e kuotave për programet e studimit, përfshirë dhe këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UT/FSHN bën përzgjedhje të kandidatëve për këtë program studimi përmes aplikimit nga ana e kandidatëve që kanë shprehur interes në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Ligjin nr. 80/2015, ✓ VKM-në mbi përcaktimin e kriterit të notes mesatare për pranimin e kandidatëve, ✓ Udhëzimeve të MAS si dhe Maturës Shtetërore, ✓ Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve nga trojet <p>Gjithashtu sipas RVB, Departamenti i Kimisë Industriale shpall listën e kandidatëve fitues për programin “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” me renditjen përkatëse përpara fillimit të procesit mësimor. Sipas dokumentit nr. 5.10, numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH dhe aktet e brendshme rregullatore të UT-së dhe ato janë të kuptueshme për publikun. Në bazë të legjislacioneve, udhëzimeve dhe VKM të përmendura më sipër DKI ka marrë përsipër të vlerësojë kandidatë që jetojnë brenda dhe jashtë vendit, me statusin e personit me aftësi të kufizuar, statusi i jetimit, ballkano-egjiptiane, transferim studimesh apo dhe aplikim për degë të dytë.</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, para cdo fillimi të vitit akademik, UT/ FSHN organizon ditët e informimit të maturanëve ku pedagogë dhe studentë takojnë gjimnazistë. Këto janë të shprehura dhe në dokumentin nr.5.12 dhe të paraqitura në ëbsite e FSHN. Për këtë process ka dhe një calendar takimesh si ai i paraqitur në dokumentin “Kalendari i veprimtarive për ditët e informimit të maturanëve 2020-2021”.</p>

	Në këto takimesh përndahen broshura (dokumenti nr. 5.13) dhe material të tjera inofrmuese mbi kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të programeve të studimit për të cilin bëhet fjalë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Sipas GVB, në Rregulloren e programit të studimit (dokumenti nr. 1.20) janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, detyrimeve akademike, etj. I njëjti informacion gjendet dhe online në ëbsite e fakultetit ku studenti njihet me planin mësimor të të treja viteve, (dokumenti nr. 1.16, fq 10), kriteret e cdo lende dhe syllabuset për mendyrën e vlerësimit (dokumenti nr. 1.16, fq 21 , model syllabusi sipas VKM 41), sezonet e riprovimeve: periudha dhe kriteret, detyrimet për marrjen e diplomës apo dhe nr I krediteve që I duhen studentit të kalojë një vit akademik. Të gjitha këto janë të paraqitura dhe në rregulloren e studimeve në dokumentin nr. 1.20, në nenin 31, 34 dhe 40. Para cdo fillim viti akademik, organizohen takime me studentët nga përgjegjesit e departamenteve ku studentët marrin informacionet e nevojshme. Sipas RVB, cdo informacion tjetër i nevojshëm vihet në dispozicion nga kujdestari akademik, Sekretaria mësimore, Përgjegjësit e departamenteve etj.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas GVB, për transferimin e plotë ose të pjesshëm të degëve, student duhet të kalojë ne komisioni i ekuivalentimit të lëndëve, i cili gjendet në cdo department. Kjo formë bazohet në Statutin e UT (dokumenti nr. 1.2), Rregullore e saj (dokumenti nr. 1.8), Rregulloren DKI (dokumenti nr. 1.6) si dhe në rregulloren e këtij programi studimi (dokumenti nr. 1.20).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Sipas RVB, kriteret e vlerësimit të studentëve janë paraqitur në rregulloren e studimit të këtij programi studimi (dokumenti nr. 1.20) dhe syllabuseve (dokumenti nr. 1.10), të cilat i prezantohen studentëve në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu i lëndës. Dita e parë e çdo moduli i dedikohet sqarimit me studentët të syllabusit i hartuar sipas VKM 41: konceptet themelore të lëndës, objektivat, literatura që do përdoret, mënyra e vlerësimit, kërkesat e pedagogut etj. Sipas Rregullores se Departamentit të Kimisë Industriale, (dokumenti nr. 1.6) njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve të ndërmjetme, projekteve/detyrave të kursit sipas afateve të caktuara nga pedagogu përkatës, dhe vlerësimit përfundimtar të caktuara në kalendarin e strukturës akademike

	(dokumenti nr. 2.17), të vendosura dhe në faqen e internetit të FSHN dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Sipas RVB, Departamenti i cili ofron këtë program studimi informon studentët në lidhje me kriteret e diplomimit. Procedura e detajuar e diplomimit paraqitet në disa dokumentë të cilët janë vënë në dispozicion nga GVB si: Statutin e UT-së (dokumenti nr. 1.1), Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore (dokumenti nr. 1.20) dhe Rregullore e Diplomimit (dokumenti nr. 4.4). Sipas RVB, kujdestari akademik dhe përgjegjesi i departamentit kanë për detyrë të informojë studentët për këto kriteret. Sipas kriterëve të vendosura në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e diplomimit, me referenca si më lart, studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar mbi bazën e një programi të detajuar (dokumenti nr. 2.25), pasi kanë plotësuar detyrimet akademike dhe financiare, që konfirmohen nga sekretaria mësimore. Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën përkatëse (dokumenti nr. 2.5), pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Sipas RVB, para fillimit të procedurës së plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve, Shkurt-Maj, UT në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, Alumni-t dhe me njësitë bazë/ kryesore të UT-së organizon ditët e informimit të maturantëve. (Dokumenta të ngarkuar në faqen e internetit të FSHN.). Sipas dokumentit nr. 6.20, DSBCK përgatit një raport mbi punën e saj vjetore në ndihmë të maturantëve. Sipas dokumentit nr. 4.12, pedagogë dhe studentë të FSHN/DKI takojnë gjimnazistë dhe prindër të interesuar për të vazhduar studimet në programet mësimore të FSHN/DKI dhe i informojnë ata mbi natyrën dhe kërkesat e programeve të studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit në këto programe, çfarë përparësish ka studimi në FSHN etj. Fakulteti u vë në dispozicion studentëve udhëzues të posaçëm (siç psh fletëpalosje (dokumenti nr. 5.7) dhe broshura informuese (modeli në dokumentin nr. 4.13), si dhe mundësinë që informacionin ta aksesojnë edhe në rrugë elektronike në faqen eeb të fakultetit. Cdo fillim viti akademik, organizohen orë të hapura orientuese/ informuese (dokumenti nr. 5.15) me përgjegjës të departamentit dhe kujdestarin akademik, ku studentët njihen me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Një rol me rëndësi në këtë program studimi, ka edhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës që siguron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët, e demonstruar në dokumentin nr. 5.17. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit. Ky këshillim konsiston në asistencën që u jepet studentëve për çështje të tilla si psh. të njohim fakultetin, takime/ leksione të hapura, si të shkruhet një CV, një letër motivimi (dokumenti nr. 5.18), prezantimi në një intervistë, etika në komunikim, etj. Kjo zyrë

	shërben dhe si urë lidhëse për studentët, midis universitetit dhe tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentave të vënë në dispozicion, shikohet se studentët e programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” informohen në mënyrë të hollësishme dhe të vazhduar gjatë gjithë periudhës së studimit për strukturën e pasqyruara në planin mësimor të këtij programi studimi, dokumenti nr. 1.9, organizimin, sipas rregullores së DKI, dokumentin 1.6 dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nga tre burime burime të ndryshme sipas detyrave përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>Sekretaria mësimore</i> pranë DKI/ FSHN, në bazë të rregullores së Sekretarisë Mësimore, dokumenti 4.21, asiston gjithë rrugëtimin e studentëve, nga regjistrimi i studentëve deri në periudhën e diplomimit. ✓ <i>Koordinatori i programit të studimit/Përgjegjësi departamentit</i> i programit Bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” bazuar në Rregulloren e DKI dhe atë të programit të studimit punon që ndërsa studentët marrin ndihmë gjatë këshillimit orientues fillestar, t’i nxis ata të kërkojnë ndihmë individuale sa herë që kanë nevojë. ✓ <i>Kujdestari akademik</i>, sipas detyrës së përcaktuar në rregulloren e këtij programi 9 dokumenti nr. 1.20) kontakton me studentët që në ditën e parë të fillimit të shkollës dhe në vazhdim sipas kërkesës së studentëve për këshillim. <p>Kujdestari akademik i departamentit sqaron studentët mbi gjithë informacionin e nevojshëm që mendohet se do të kenë përgjatë rrugëtimin të tyre. Disa nga informacionet që marrin janë: Çfarë janë syllabuset dhe kur bëhet shpjegimi i tyre, cilat janë lëndët e detyruara, si veprohet me lëndët me zgjedhje, orari i sezonit, ku ndodhen klasat ku zhvillohen leksionet, seminarët, si dhe ku zhvillohen laboratorët. Cilat janë kërkesat e paraqitjes profesionale në orët e laboratorëve, format e vlerësimit (si zhvillohen provimet), procesi i ankimit të pikëve të marra në provime, ku mund të gjejnë literaturën e kërkuar nga pedagogët, riprovimet, sezonet e veçanta, dënimet për mashtrim në provim, plagjiaturë etj</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të</p>	<p>Sipas RVB, DKI/ FSHN i vendos në dispozicion studentëve të programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” informacion të ndryshme si: guida e fakultetit e paraqitur në dokumentin nr. 5.5 dhe dokumentacion/ udhëzues si: Rregullore departamenti (dokumenti nr. 1.6), Rregullore programi (dokumenti nr. 1.20) plane</p>

<p>posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>mësimore (dokumenti nr. 1.16) me informacion për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Për të informuar studentënë IAL përdor dhe faqen zyrtare të FSHN dhe sistemit elektronik (dokumenti nr. 4.24), një burim tjetër informacioni është dhe Biblioteka e FSHN/UT e paraqitur në dokumentin nr. 1.2.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>UT, sipas RVB ka kryer studime të tregut të punës në lidhje me tendencat e tregut, të cilat kanë treguar sipas dokumentit nr.1.14, se studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë treg të konsiderueshëm pune mbi 50%. Pjesa më e madhe prej tyre preferon sektorin privat, rreth 43 % dhe 22% sektorin shtetëror. Sipas anketimit të realizuar për këtë program studimi, të praqitur në dokumentin nr. 1.15, u konkludua se studentët të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë (ose janë duke përfunduar ciklin e dytë të studimeve) punësohen në institucione publike ose private. Nga ky studim rezultoi se 27.1% e të anketuarve janë të punësuar, 10.2% janë në pritje të punësimit dhe 62.7% janë pa punë. Nga të anketuarit e punësuar rezultoi se 18.1% punojnë në sektorin publik dhe 81.8% në sektorin privat. Nga të punësuarit e sektorit publik rezultoi se 13.6% punojnë në administratën shtetërore, 4.5% punojnë në institucion publik të arsimit të lartë. Nga të punësuarit në sektorin privat rezultoi se 4.5 % janë të vetëpunësuar. Sipas RVB dhe dokumentave të vënë në dispozicion, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij. Ofron mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës nëpërmjet leksioneve të hapura (dokumenti nr 5.17), intershipeve, ëorkshopeve, panairit të karrierës etj (dokumenti nr. 1.16, 5.19, 5.20 , 5.21). Sipas dokumentit të paraqitur në faqen e ëeb-it të UT, është organizuar “Java e Europës Në UT”, me temë “Shqipëria dhe Bashkimi European mbështesin të rinjtë nëpërmjet universitetit”, e cila synon të përfshijë studentët në periudha shkëmbimi në universitetet partnere të BE duke ndihmuar formimin e tyre dhe aftësimin më tej në tregun e punës. <i>Shenim: Do të ishte mirë që studime të ngashme të kryhen gjithmonë jo vetëm në kuadër të Akreditimit Institucional, pasi ndihmojnë të shikohet pozicionimi i studentëve të këtij programi në tregun e punës në vazhdimësi, pas tregu është shumë dinamik dhe programet e studimeve duhet të përshtaten me të.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sipas RVB, Në cdo fillim viti akademik, marrin informacion nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, asaj të departamentit, email personale apo dhe sekretaria mësimore mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. (eëë.fshn.edu.al) Sistemi e-Student që pritet të vendoset në dispozicion të të gjithë stafit dhe studentëve do tju japë mundësi studentëve të marrin më shume informacion mbi Departamentin, Planet mësimore, lëndët dhe modulet, Grupet mësimore, Listat e notave, Çelja e sezoneve të provimeve, Rregjistrimin në provime, Historikun e regjistrimeve në</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të</p>	<p></p>

menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	provime etj. Gjithashtu sipas dokumentit nr. 5.23 , stafi akademik ka mundësi që në sistemin e-Student të modifikojë të dhënat personale, kontrollojë grupet mësimore, të realizojë hedhjen e notave për studentët e grupeve të tij mësimore, kontrollojnë kërkesat për përmirësim të ardhura nga studentët, kontrollojnë kërkesat për ankimim vlerësimi të ardhura nga studentët etj, attribute të përmendura dhe në kritere të mëparshme në këtë raport.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Sipas RVB, FSHN zbaton në bazë të LAL 80/2015 dhe Rregullores së UT-së, procedurën për mbajtjen e të dhënave të Studentëve. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen në formë të shkruar të: <ul style="list-style-type: none"> ✓ regjistrin themeltar të studentëve (dokumenti nr. 3.32, tregon shembull të një regjistri), ✓ regjistrin me të dhënat akademike (dokumenti nr. 3.33), ✓ regjistrin e lëshimit të diplomave (dokumenti nr. 3.34). Në bazë të rregullores së Sekretarisë, dokumenti 4.21 , ajo ka për detyrë dhe të arkivojë dokumenta si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ✓ dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacion sipas udhëzimeve të përvitshme të MAS, ✓ procesverbalet me rezultatet e testimeve të njohurive të studentëve dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor,
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ dosjet e programeve të dyta të studimit, ✓ statistikat e studentëve që diplomohen, ✓ statistikat e studentëve frekuentues, ✓ statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit, ✓ statistikat e studentëve që ç'rregjistrohen etj. Sipas dokumentit nr. 4.27 , që është një urdhër për për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës, këto të dhëna ruhen në kasafortën e Sekretarisë mësimore. Në tabelën 21 dhe 23 të dokumentit nr. 1.16 , tregohen evidence mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Bachelor ne Kimi dhe Teknologji Ushqimore. Gjithashtu aty mund të gjejmë informacion mbi tërheqjet nga programi, transferimet apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në këtë program studimi. Sipas RVB, këto statistika disponohen dhe në nivel
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ dosjet e programeve të dyta të studimit, ✓ statistikat e studentëve që diplomohen, ✓ statistikat e studentëve frekuentues, ✓ statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit, ✓ statistikat e studentëve që ç'rregjistrohen etj. Sipas dokumentit nr. 4.27 , që është një urdhër për për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës, këto të dhëna ruhen në kasafortën e Sekretarisë mësimore. Në tabelën 21 dhe 23 të dokumentit nr. 1.16 , tregohen evidence mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Bachelor ne Kimi dhe Teknologji Ushqimore. Gjithashtu aty mund të gjejmë informacion mbi tërheqjet nga programi, transferimet apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në këtë program studimi. Sipas RVB, këto statistika disponohen dhe në nivel

	<p>departamenti dhe paraqiten dhe në raportet vjetore institucionale si dokumenti nr 1.42.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sipas RVB, për të ruajtur të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve, angazhohet Sekretaria Mësimore.</p> <p>Sipas rregullores së Sekretarisë Mësimore, dokumenti nr. 4.21, aty disponohen të dhëna si procesverbale provimesh, riprovimesh etj dhe janë të aksesueshme nga persona të autorizuar. Për mbrojtjen e të dhënave përdoret platforma mbrojtëse si fireëall etj.</p> <p>Në bazë të dokumentave të vënë në dispozicion nga GVB, dokumenti nr. 4.21, 3.32, 3.33 del qartë se Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni menaxhohet dhe ruhet në database e sekretarisë. Po ashtu, pedagogu i lëndës mban regjistrin e tij, dokumenti nr. 1.19, si dokument që evidenton dhe vërteton zhvillimin e orës së mësimit nga ai dhe frekuentimin e orës së mësimit nga studenti. Për dokument të vlerësimit të studentëve është procesverbi të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve dhe në përfundim depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Në Regjistrin themeltar, dokumenti nr. 3.32, në Regjistrin e rezultateve akademike (dokumenti nr. 3.33) të studentit si dhe në Regjistrin e Diplomave pasqyrohen të dhënat e studentëve. Këto të dhëna janë/mbahen edhe në database përkatës. Sipas rregullores “Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës”, dokumenti nr. 4.24, të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin. Së shpejti këto të dhëna do të bëhen pjesë e sistemit e-Student.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sipas RVB, Në zbatim të Udhëzimit të MAS (dokumenti nr. 4.32, 5.24), UT harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, në të cilin vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. (dokumenti nr. 5.25). Sipas RVB, raporti, bazohet në evidencat dhe raportet e njëjve kryesore/ bazë dhe rektoratit dhe përmban profiling dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. (dokumenti nr. 1.42)</p> <p>Dokumenti nr. 1.14 dhe 1.15 të cilët janë studime tregu në nivel UT dhe në nivel departamenti, tregojnë shkallën e cilësisë së punësimit të studentëve (gjurmimi i studentëve).</p> <p>Raportet janë të shoqëruara me masat/rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Një nga treguesit e cilësisë së mësimdhënies në analizë është edhe mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në program (dokumenti nr. 5.26), si dhe kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve (dokumenti nr. 6.14). Në analizat vjetore të paraqitur në dokumentin nr. 1.48 dhe 4.11, departamenti paraqet rezultate analitike mbi numrin e të regjistruarve, dhe të diplomuarve të programit të studimit.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Sipas RVB, studentët që janë pjesë e UT, kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes, në përputhje me përcaktimet e bëra në IAL, 80/2015 dhe akteve të tjera në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në organe drejtuese dhe komisione si: Senati Akademik ka 4 antarë përfaqësues të studentëve. Në dokumentin nr. 1.43, që është një vendim i Senatit Akademik, ka firmosur dhe një student në përfaqinë e antarit të këtij Senati; ✓ Këshillat studentorë, sipas rregullores se zgjedhjes së Këshillave Studentorë, dokumenti nr. 5.27; ✓ Këshillin e Etikës, në bazë të Statutit të UT dhe Vendimit të Senatit ka 2 antarë përfaqësues të studentëve; ✓ Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me studentët ka 3 antarë përfaqësues të studentëve (dokumenti nr. 1.2, 5.29 dhe 1.44); ✓ Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës ka 2 antarë përfaqësues të studentëve (dokumenti nr. 3.10); ✓ Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni ka 3 antarë përfaqësues të studentëve (dokumenti nr. 1.2, 1.43); ✓ Studentët janë pjesë përbërëse e grupeve të vlerësimit mbi procesin akademik (dokumenti nr. 1.2, 6.3 dhe 1.16 tab 24). <p>Në nivel institucional dhe njësie kryesore, studentët kanë këshillin e tyre studentor përmes një procesi zgjedhor të administruar nga KIZS, shembull është dokumenti nr. 5.30.</p> <p>Sipas Rregullores së zgjedhjeve të këshillit studentor, dokumenti nr. 5.27, përfshirja e studentëve në process është e gjerë.</p> <p>Zgjedhjet e fundit janë mbajtur në 16.12.2021 (dokumenti nr. 5.32)</p> <p>Përveç komisioneve, studentët japin mendimin e tyre dhe nëpërmjet pyetësorëve, të cilët mund të plotësohen online. Në dokumentë përfshihen pyetje të ndryshme që lidhen me aktivitetin akademik të studentëve. Sipas dokumentit nr. 6.14, dhe dokumentave të tjerë të vendosur në dispozicion (dokumenti nr. 6.11, 6.12, 6.13) këto pyetësorë përpunohen dhe rרתohen raporte ku merren parasysh dhe komentet dhe dalin rekomandime për përmirësim.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë</p>	<p>Sipas RVB, në hartimin e planit mësimor dhe orarit semestral, mbahet parasysh dhe shpërndarja e ngarkesës së studentëve midis punës në auditor dhe asaj jashtë saj në mënyrë që të mos ketë mbingarkesë për</p>

<p>parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>ta. (dokumenti nr. 1.9 dhe 2.14, japin informacione mbi planin mësimor dhe orarin, për të pasqyruar shpërndarjen e punës së studentëve në auditor dhe asaj në jashtë saj, gjithmonë duke u bazuar në përcaktimet e VKM 41 dt 24.01.2018. Sipas RVB, njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore Statutit të UT (dokumenti nr 1.2), Rregullorja e UT (dokumenti nr. 1.8). Në dokumentin nr. 1.31 dhe 4.35 është përshkruar një procedurë transferimi studimesh, ku nëse ka kërkesa p.sh.për njohje dhe transferim kreditesh të studimeve, ngrihet komisioni transferimit dhe/ose ekuivalentimit në nivel departamenti për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Këto procedura janë përcaktuar me kuadër rregullator në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, evidentuar në dokumentin nr. 1.20.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Sipas RVB, FSHN/DKI garanton përfshirjen e studentëve në procese të hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të kurrikulave nëpërmjet mekanizmave të komunikimit dhe marrjes së mendimit të tyre. Është koordinatori/kujdestari akademik ai i cili bën takime të vazhdueshme sipas kërkesës dhe nevojave. Sipas RVB dhe asaj të përmendur në kritere më sipër, njësia kryesore realizon pyetësorë për marrjen e mendimit të studentëve për çështje të caktuara që lidhen dhe me vlerësimin e programit të lëndëve, metodat e mësimdhënies etj. Të gjitha të dhënat përpunohen dhe nxirren rekomandime për tu diskutuar në mbledhje në nivel departamenti ose fakulteti. (dokumenti nr. 4.12, 4.13).</p> <p><i>Do të ishte mirë të kishte shembuj konkretë të punës së kujdestarit akademik me studentët.</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas RVB, studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, sipas VKM 41, si vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar, këtë të fundit mund ta marrin dhe në sekretari.</p> <p>Bazuar në rregulloren e UT (dokumenti nr. 1.8), Rregullore e DKI (dokumenti nr. 1.6) dhe Rregullore e këtij programi studimi (dokumenti nr. 1.20) RVB paraqet procedurën e ankimimit të vlerësimit nga studenti. Disa nga pikat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, brenda 24 orëve te shefi i departamentit me shkrim. ✓ Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Kërkesën me shkrim për rivlerësimin e tezës së tij të provimit studenti e dorëzon tek shefi i departamentit (sekretaria e departamentit) brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit. ✓ Drejtuesi i departamentit, bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin. ✓ Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision <i>ad hoc</i> prej 3 anëtarësh, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit duke

	<p>vlërësuar provimin më shkrim të plotësuar prej tij. Në rastin e provimeve me gojë, studenti përsërit provimin në prani të komisionit <i>ad hoc</i>, duke tërhequr një tezë të dytë. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.</p> <p>✓ Ndryshimet në rezultatet e studentëve nëse ka, pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Sipas RVB, burime të besueshme për të informuar studentët mbi çdo kërkesë të tyre janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sekretaria mesimore, e cila bazuar në rregulloren e saj, dokumenti nr. 4.21 mundëson shërbimet akademike nga regjistrimi në diplomim. 2. Kujdestari akademik për marrëdhëniet me studentët, bazuar në rregulloren e këtij programi, funksionon shumë mirë, duke këshilluar në mënyrë intensive studentët, jo vetëm ata të sapo regjistruar në vitin e parë. <i>Në dispozicion të RVJ, janë vendosur dokumenta që tregojnë punën e tyre por janë shumë përgjithësuese. Do të ishte mirë të ishin vendosur disa materiale dhe problematika të zgjidhura pikërisht nga Kujdestari akademik, në mënyrë që të tregohet qarta puna e tyre, jo vetëm në rregullore apo shkresa.</i> 3. Faqja eeb e fakultetit, një sistem shumë funksional informimi sidomos sesioni “Njoftime”. Njëpërmjet tij studentët njihen në kohë reale, jo vetëm me aktivitetet korrente të FSHN-së, por edhe çdo lloj njoftimi i nevojshëm për studentët (orari mesimor, orari provimeve, shtyrjet e datave, lajmërimet për aplikimet ERASMUS etj.). Sipas RVB DKI ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, njëpërmjet orëve të konsultimit ose orëve zëvendësuese të laboratorit, të zhvilluara me pedagogët.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mesimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB Dega së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mesimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale, vlefshmërinë e diplomës dhe orientimin në tregun e punës. Studentët asistohen/këshillohen për këtë qëllim dhe marrin informacionin e nevojshëm njëpërmjet aktiviteteve, sikundër ajo e organuar nga UT “Java e Europës”, dhe takimeve të organizuara (leksioneve të hapura) nga Dega e Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, procese të përcaktuara</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mesimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën</p>	<p>Sipas RVB Dega së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mesimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën</p>



<p>profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>në rregulloren e kësaj njësie, dokumenti nr. 6.21. Disa nga proceset që ajo mbulon janë për të:</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>✓ ndërgjegjësuar studentët për preferencat e tyre individuale dhe mundësitë e disponueshme në treg (duke i orientuar ata për praktikatat profesionale pranë institucioneve/kompanive. Një listë e marrëveshjeve të FSHN me institucione shtetërore dhe private është vënë në dispozicion, që tregon bashkëpunimin e gjerë me kompani si “Lufra”, “Mielli Diamond”, Njësia vendore e kujdesit Shendetësor, Pogradec, marrëveshje të firmosura në periudhën 2019-2021.</p> <p>✓ njohur studentët me pritshmëritë, kërkesat dhe standartet e tregut (duke organizuar dhe histori suksezi me ish studentet e DKJ), në faqen e FSHN ka disa histori suksezi.</p> <p>✓ përgatitur studentët për prezantimin e parë me punëdhënësin (CV, letër motivuese, intervistë, etj.).</p> <p>✓ Njoftime për intershipe të ndryshme (<i>dokumenti nr. 5.33, 5.19, janë informacione mbi mundësi punësimi, por do të ishte mirë që GVJ, të kishte në dispozicion njoftime për intershipe për këtë program studimi</i>).</p> <p>✓ për të ndërtuar së bashku planifikimin e karrierës (dokumenti nr. 5.17).</p> <p>✓ duke ndërmjetësuar punësimin e tyre, sipas dokumentit nr. 5.20, shikohet komunikimi i DKJ me DSBCK, mbi mundësinë e punësimit të studentëve ekselentë në kompaninë “Argoblend” sh.p.k.</p> <p>✓ duke i orientuar për programet e shkëmbimit Erasmus +, shkolla verore etj të cilat janë të përditësuar dhe ngarkuara në faqen e internetit të UT.</p> <p>Sipas GVB, në UT funksionojnë dhe dy struktura të tjera, në funksion të ndërmjetësimit për punësimin e studentëve si:</p> <p>✓ Platforma Gradua e cila mundëson krijimin e kontakteve midis Universitetit dhe tregut të punës. Falë rregjistrimit në platform, studentët mund të kontaktohen individualisht nga kompanitë. Në dokumentin nr. 5.34, tregohet dhe mënyra e përdorimit të kësaj platforme, por do të ishte mirë të kishim në dispozicion një raport të kësaj platforme, mbi numrin e subjekteve dhe studentëve të rregjistruar, dhe sa prej tyre janë punësuar prej rregjistrimit në këtë platform.</p> <p>✓ Qendra e karrierës Alumni, e cila ka faqe të saj internet www.qal.unitir.al.</p>			

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR



Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas RVB, Senatit i UT, ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e tij, Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Paketën e Instrumentave të Cilësisë. (dokumenti nr. 6.1 dhe 6.2). Për të siguruar cilësinë në të gjitha fushat e veprimtarisë të këtij universiteti. Në nivel institucional, është ngritur dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës me funksione të përcaktuara në Statutin e këtij Universiteti. (dokumenti nr. 1.43, 1.16 tab 24 dhe 1.2).</p> <p>Sipas RVB, në dokumentin nr. 6.5, vendim Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2018”, pika 2, “Miratimi i strukturave për njësitë e UT-së, FSHN ka ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila luan rolin e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel njësie kryesore. Kjo degë në bashkëpunim me zyrën e Zëvendës-Dekanit të Ciklit të Parë dhe të Dytë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi dhe harton raportet përkatëse, sipas Statutit të këtij universiteti. (dokumenti nr. 1.2).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentave të vënë në dispozicion nga GVB, tregohet se KPSSC është struktura përgjegjëse e ngarkuar nga Senati Akademik për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Me vendim senati akademik, dokumenti nr 1.43, ai është i përbërë nga 11 antëtarë, 8 antëtarë personel akademik dhe 3 antëtarë student, ku FSHN përfaqësohet në këtë komision nga 1 antëtar personel akademik. UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë e cila mund të gjendet në faqen e internetit të UT, (https://unitir.edu.al/struktura-organizative/), struktura ndihmës akademike që punon për zbatimin e politikave mbi cilësinë dhe që mbështet me veprimtarinë e saj KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore. Sipas RVB, një prej mekanizmave të krijuara për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FSHN, është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), sipas organigramës së FSHN, shprehur në dokumentin nr. 1.23. Hapja e DSBCK bazohet në dokumentin nr. 6.52 i cili është vendimi Nr. 39 i Bordit të Administrimit datë 04.04.2018. Sipas rregullores së DSBCK (dokumenti nr. 6.21), ajo ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. Kjo degë është në varësi të Dekanit të FSHN dhe aktualisht operon me dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist, të dhëna të paraqitura në dokumentin nr. 1.6, tabela 24.</p>



<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sipas RVB, UT funksionon në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, dhe si i tillë zbaton dy instrumenta për të siguruar cilësinë në UT: Akredimi Institucional dhe Akreditimi i programeve të studimit. Sipas dokumentit nr. 1.11, UT është akredituar për një periudhë 4 vjecare akademike dhe ka riakreditim pas Tetor 2022.</p> <p>Sipas RVB, Për kontrollin e sigurimit të cilësisë, UT planifikon përgatitjen e raportit vjetor mësimit-kërkimor analizën e programeve të studimit dhe kurrikulave dhe përmirësimin e tyre në masën 20%, analizën e programeve lëndore dhe përmirësimin e tyre, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të instrumentave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë etj. duke promovuar kështu përmirësimin e cilësisë. Po sipas RVB, DSBCK në FSHN bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë bazë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të mundësuar vlerësimin e brendshëm, sipas dokumentit nr. 6.4, FSHN bazuar në tipet e pyetësorëve të ofruara nga paketa e instrumentave, fton studentët me anë të njoftime si dokumenti nr. 6.7, në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët/formularët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit. DKI si pjesë e FSHN/UT harton analizat vjetore ku ndër të tjera në të përfshihen edhe tipet e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik dhe konkluzionet përkatëse. (dokumenti nr. 1.48).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sipas RVB, UT në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentin nr. 1.2, Statuti i UT, Në Kreun X të saj, janë përshkruar qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në dokumentin nr. 6.3, që është Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Përveç, pyetësorëve periodikë, DKI harton në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij duke synuar në këtë mënyrë krijimin e kulturës së cilësisë në nivel Departamenti/Fakulteti, të paraqitura në dokumentin nr. 1.48 dhe 4.11.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB, për të monitoruar, shqyrtuar, mbikëqyrur, programete studimit, UT ka ngritur një sërë strukturash/sectorësh ku Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës shërbejnë si strukturë e posaçme</p>

	<p>për monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni. (Dokumenti nr. 1.43 dhe 1.16, tabela 24).</p> <p>Sipas RVB, në nivel Njësie Kryesore, sipas organigrames së kësaj njësie, duket qartë se për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë të programeve të studimit të ciklit të parë është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Funksion i miratuar dhë me Vendim Senati, dokumenti nr. 6.5.</p> <p>Sipas RVB, në kuadër të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të parë, Përgjegjësit e Departamenteve komunikojnë me Zëvendës-dekanin e Ciklit të Parë të Programit të Studimit dhe Zëvendës-dekanin për kërkim shkencor, të cilët koordinojnë dhe planifikojnë raportimet e punës mësimore dhe kërkimore. Rezultatet e këtyre veprimtarive pasqyrohen në Raportet Vjetore të Njësive Kryesore bazuar në raportet vjetore të Njësive Bazë (dokumenti nr. 1.42) si dhe në analizat vjetore të njësive bazë (dokumenti nr.1.48 dhe 4.11).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB, DKI/FSHN/UT përdor mekanizma për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, ku disa prej të cilave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale, si dokumenti nr. 6.6 dhe 6.16, të UT si dhe raportet vjetore të fakultetit/departamentit të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. ✓ Në Departamentin e Kimisë Industriale procedurat për ndryshime në programin e studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore është bërë referuar bazës ligjore (Ligji Arsimit të Lartë, VKM, Urdhëra, Udhëzime prej MAS). Ndryshimet kanë ndjekur procedura standarde dhe janë shprehur në dokumentat nr. 2.20 dhe 6.22. ✓ Plotësimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies i cili realizohet për lëndët e çdo programi studimi në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve. Në përfundim të tij hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore. Një shembull plani masash është dokumentuar në dokumentin nr. 6.9 hartuar në 31.01.2021, ku sipas rezultateve të pyetësorëve, do të diskutohet në mbledhje departamenti për të marrë dhe aprovimin e stafit akademik, për ndryshimet që kërkohen në dy syllabuse.
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve dhe për këtë është përgjegjëse, bazuar në dokumentin nr. 6.21, që është Rregullorja e DSBCK_FSHN, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës e cila në bashkëpunim me Dekanatin realizon pyetësorët e përvitshëm. Pyetësorët e parashikuar në paketën e instrumentave (dokumenti nr. 6.4) janë disa ku mund të përmendim:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Në përfundim të çdo semestri është parashikuar pyetëtori “Vlerësimi i lëndës nga studentët”. Pyetëtori aksesohet nëpërmjet faqes zyrtare të FSHN vetëm nga studentët që kanë llogari elektronike aktive me FSHN. ✓ Gjatë sezonit të diplomimit në muajin Korrik është parashikuar zhvillimi i dy pyetësorëve. Pyetëtori i parë është “Vlerësimi i studentëve që diplomohen”. Qëllimi i këtij vlerësimi është që studentët e diplomuar të japin mendimin e tyre kritik për cilësinë e programeve të studimit, ndërsa i dyti është “Raport i studentëve”. Qëllimi i këtij raporti është që studentët e diplomuar të japin përshtypjet/vlerësimin e tyre në lidhje me cilësinë e arsimimit në FSHN/UT. ✓ Në përfundim të çdo semestri parashikohet pyetëtori “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” ku secili anëtar i personelit akademik bën një analizë të lëndëve ku janë titullarë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje. <p>GVB, në raport ka vënë në dispozicion për të parë dhe në anë praktike pyetësorët dhe disa nga gjetjet e tyre në vite. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Statistika në nivel programi studimi, semestri i parë, viti akademik 2020-2021, paraqitur në dokumentin nr. 6.10. ✓ Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit semestri parë viti akademik 2020-2021, paraqitur në dokumentin 6.11. ✓ Raport mbi pyetësin “Vlerësim i studentëve që diplomohen” 2020-2021, e paraqitur në dokumentin nr. 6.12. ✓ Raport për pyetësin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit viti akademik 2020-2021(dokumenti nr. 6.13). Pyetësorët janë shpërndarë tek studentët fizikisht (hardcopy) dhe materialet janë të depozituara pranë zyrës DSBACK ✓ Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu semestri i parë, viti akademik 2020-2021 (dokumenti nr. 6.14) etj <p>Sipas RVB, rezultatet e anketimeve/pyetësorëve shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë në përmirësimin e veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Të gjitha gjetjet më pas dikutohen në mbledhje departamenti.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, DKI, cdo fund viti akademik, përgatit analizën vjetore (dokumenti nr. 1.48) i cili përdoret më tej për raportin vjetor në nivel fakulteti. Analizat vjetore në nivel departamenti dhe raportet vjetore në nivel fakulteti përmbajnë vlerësimin e mbarëvajtjes së programeve të studimeve, ku disa nga elementët matës janë: Numri i studentëve të regjistruar për çdo vit akademik; numri i studentëve të diplomuar për çdo vit akademik; studentë të shkëlqyer; studentë të ç’regjistruar; plotësimi i standarteve të stafit akademik/artikuj të botuar, pjesëmarrjet në konferenca, projekte etj. sponsorizimet për konferencat dhe artikujt, përmirësimi i standarteve të ambienteve/didaktikës laboratorike (përmirësimi i strukturës laboratorike); përqindja e kalueshmëri-në dhe përqindja e të diplomuarve; ngarkesa mësimore e personelit akademik;</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	

	<p>konkluzionet e pyetësorëve të studentëve të cilat hartohen në raporte analitike të detajuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës bën të njohura raportet e saj vjetore bashkë me gjetjet dhe mundësitë për përmirësim dhe i publikon në faqen e internetit. (dokumenti nr. 6.20). Sipas RVB, në funksion të përmirësimit të cilësisë të programeve, UT ka miratuar me Vendim Nr. 30, datë 22.07.2021 të Senatit Akademik, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik paraqitur në dokumentin nr. 6.17 dhe 6.18. Manuali i vlerësimit të performancës përcakton mënyrën dhe metodën e vlerësimit të personelit akademik Universitetit të Tiranës të të gjitha kategorive. Ai është organizuar në disa pjesë dhe trajton parimet, kriteret dhe periudhën e vlerësimit, që duhen zbatuar gjatë gjithë procesit të vlerësimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Sipas RVB, analizat vjetore të hartuara në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në raportet vjetore në nivel universiteti, janë pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit (dokumentat nr. 1.14). Gjithashtu raportet/ analizat e përvitshme të pyetësorëve, të paraqitura në dokumentët nr 6.10-6.15, të hartuara dhe realizuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës e cila ka funksionin e Njesisë të Brendshme të Cilësisë janë gjithashtu pjesë e këtij vlerësimi. Këtu përfshihen edhe raportet vjetore të DSBCK të cilat bëhen publike në faqen elektronike të FSHN të përmendur si procedurë dhe në kriteret më sipër të këtij raporti.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sipas RVB, në UT, GVB e ngritur në kuadër të Akreditimit Institucional në vitin 2018, dokumenti nr. 2.8, ka hartuar Raportin e Vetëvlerësimit Institucional dhe ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës dhe strukturat e tjera të institucionit të angazhuara në përmirësimin e cilësisë. Në funksion të përmirësimit të cilësisë të programeve UT ka miratuar: ✓ Manualin e Sigurimit të Cilësisë, si dhe procedurat për zbatimin e saj (Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë dhe Paketën e Instrumentave të Cilësisë), dokumentat nr. 6.2, Manuali i Cilësisë, dokumenti nr. 6.3 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, dhe dokumenti nr. 6.4, Paketa e instrumenteve të cilësisë.

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, paraqitur në dokumentin nr. 6.17. ✓ Miratimi në parim i Rregullores “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” (dokumenti nr. 6.19). ✓ Sipas RVB, me vendim Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018 është krijuar Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës (dokumenti nr. 6.5) si njësi operative në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila ka mundësuar realizimin/plotësimin e pyetësorëve të ndryshëm nga ana e studentëve. <p>Sipas RVB, të gjitha këto instrumenta përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit që IAL ofron.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas RVB, FSHN dhe Njësitë Bazë të tij në kuadër të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programeve të studimit përdorin metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo pasqyrohet në dokumentacionin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Çdo vit akademik DKI, FSHN, UT hartojnë raporte vjetore ku pasqyrohet veprimtaria e njësisë bazë, kryesore dhe asaj institucionale duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. (dokumenti nr. 1.42). ✓ Çdo vit akademik realizohen ndryshimet në masën 20% të planeve mësimore, sipas dokumentit nr. 2.20 dhe 6.22 të cilat miratojnë planet mësimore për vite të ndryshme akademike. ✓ Dekanati ushtron kontrolle mbi zhvillimin e procesit mësimor. ✓ DSBCK realizon pyetësorët e përvitshëm dhe harton analizat përkatëse (dokumentat nr. 6.10-6.15, ku paraqiten statistika, vlerësime e vetëvlerësime di dhe rekomandime për përmirësim. ✓ DSBCK harton raportet vjetore mbi vlerësimin e cilësisë, dhe i bën ato publike, dokumenti nr. 6.20. ✓ Titullarët e Grup-Lëndëve në Njësitë Bazë në bashkëpunim me Përgjegjësit e Departamenteve për mbikqyrjen dhe monitorimin në respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera. Ato ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmës-akademik dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seanceve laboratorike, detyrave të ndryshme apo testimeve gjatë vitit akademik. Në dokumentin nr. 3.18, paraqitet një vlerësim i punës së M.Sc. O. H., ku jepet vlerësimi për përkushtimin e saj në punë dhe detyrat që i caktohen. ✓ Performanca e stafit akademik, në dokumentin nr. 3.8 është paraqitur performance e M.Sc Xh. H., ku është detajuar gjithë aktiviteti i tij akademik në fushen e kërkimit dhe mësim dhënies dhe aftitë e tij në këtë process.
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e</p>	<p>Për plotësimin e këtij kriteri, sipas RVB, FSHN/DK në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi.</p>

instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.

Sipas RVB, gjatë sezonit të diplomimit në muajin Korrik studentët e diplomuar në programin e studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” japin vlerësimin dhe mendimin e tyre kritik për cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit “Vlerësimi i studentëve që diplomohen”. Në dokumentin nr. 6.12, paraqitet raporti mbi pyetësorin të realizuar për vitin akademik 2020-2021, nga Dega e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë në FSHN, për të gjithë departamentet. Në DKI, janë marrë të dhëna nga Cikli i parë Bachelor KI, Master i Shkencave në KI dhe Mjedisore si dhe Master i Shkencave në shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore, por nuk ka të dhëna mbi pyetësorin e studentëve për Ciklin e parë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore. Do të ishte mirë të kishte të dhëna në këtë raport dhe për studentët që ndjekin këtë program studimi, për përmbushjen e kriterëve të procesit të Akreditimit, në mënyrë që të jepnin dhe ata vlerësimin e tyre.


Sipas RVB, tërheqja e mendimit të studentëve të diplomuar është realizuar edhe nëpërmjet statistikave të punësimit. Konkretisht UT, ka realizuar në vitin 2018 Studimin e Tregut në nivel institucional. Raporti jep një panoramë të specialiteteve që ofron Universiteti i Tiranës në tregun e punës bazuar në të dhënat e marra nga fakultetet e Universitetit dhe të numrit të studentëve që diplomohen.

Sipas GVB, studimi shërben për të gjykuar mbi prirjet e fundit të kërkesë ofertës në tregun e punës për të sapodiplomuarit me arsim të lartë duke e vendosur situatën e Universitetit të Tiranës në këtë kontekst. Në pyetësorin e përdorur në këtë rast janë analizuar një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me vështirësitë në gjetjen e një pune dhe rolin e cilësisë së programeve të Universitetit në lehtësimin e gjetjes së një pune. Në këtë kontekst Departamenti i Kimisë Industriale ka realizuar gjithashtu studimin e tregut të programit të studimit bachelor “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” duke tërhequr në këtë mënyrë mendimin e studentëve të diplomuar. Të dhënat e pyetësorit të realizuar në periudhën nëntor 2019 gjenden në dokumentin nr. 1.15, ku studentët janë pyetur pse kanë zgjedhur këtë degë, nëse janë punësuar apo ajo pas mbarimit të ciklit të parë të studimeve, në çfarë sektori nëse janë punësuar etj. Sipas RVB, në paketën e instrumentave është parashikuar që në fund të çdo semestri të realizohet pyetësori “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu” ku secili anëtar i personelit akademik bën një vetvlerësim/analizë të lëndëve ku janë titullarë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje. Personeli akademik jep më tej mendimin e tij kritik për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. Për vitin akademik 2020-2021 u realizua “Raporti i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu”. Në dokumentin nr 6.14, në fq 86 të tij gjenden të dhëna tabelore mbi ndryshimet. Ut aplikon një rregullore “Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës” ku neni 7 i saj shpreh se personeli ndihmës



	akademik dhe administrativ në UT përfshihet në procesin e vlerësimit të programit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, në statutin e e saj, është parashikuar përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët janë të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Kjo është përcaktuar dhe në dokumentin nr 1.3 që është strategjia e UT, në faqen 4 të tij ku një nga objektivat është dhe bashkëpunimi me aktorët e interesuar për këtë qëllim.</p> <p>Sipas RVB, bazuar ne Statutin e UT, dokumenti nr. 1.2, neni 7 I tij, UT lidh marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore shkencore, kualifikuese, inovative, duke mundurësuar kështu përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu në këtë document përshkruhen qartë dhe procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë, të UT, dokumenti nr 6.3, janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu po sipas raportit të GVB, studentët janë të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë pasi ata janë pjesë e :</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë ka 3 anëtarë përfaqësues të studentëve. Ata janë E. D., A. J. dhe E. C., votim i realizuar nga Senati Akademik me 7.12.2020, bazuar në Ligjin për IAL 80/2015. ✓ Komisioni i përhershëm i kurrikulës ka 2 anëtarë përfaqësues të studentëve, bazuar në statutin e UT, neni 42 (dokumenti nr 1.2). Studentët angazhohen gjithashtu në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (dokumenti nr 3.21, ku janë miratuar GVB për FSHN, ku si pjesë e tyre janë dhe studentët psh ne GVB e DKI për programin e studimit Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore është O.H., ndërsa në dokumentin 2.8 jo 6.23, sikunder referuar nga GVB, jepet dhe grupi i vetvlerësimit institucional ku si antar komisioni është Kristian Kina si përfaqësi e studentëve.).
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet</p>	<p>Sipas RVB, FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës duke garantuar në këtë mënyrë përfshirjen e</p>

<p>përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>njësisë kryesore në sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që ofrohen, ku M. L. është përfaqësuese e FSHN, sipas dokumentit nr. 1.43. Sipas raportit të GVB, në nivel Njësie Kryesore për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (dokumenti nr. 1.23, organigrama e UT dhe dokumenti nr. 6.15). Dega luan funksionin e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Njësie Kryesore. Studentët janë të përfshirë në procesin/sistemin e sigurimit të cilësisë së programit mësimor nëpërmjet anketimeve periodike nga DSBCK të analizuar me detaj në kriteret më sipër, marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli Studentor si dhe takimeve me Kujdestarët e programit, e diskutuar ë detaje në kriteret më sipër.</p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB, gjatë procesit të sigurimit të cilësisë nëpërmjet strukturave përkatëse, Dega e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, me qëllim vlerësimin e programeve të studimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe Ligji Nr. 9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre.</p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sipas raportit të GVB, për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut e punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës organizon Panairët e Karrierës. Panairi vjen në ndihmë studentëve në një përfaqje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe intershipi. Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> <p><i>Sipas link-ut të vendosur si referencë, Panairi daton në vitin 2014, do të ishte mirë për efekt të vlerësuesëve të vendeshin të dhëna më të rifreskuara.</i></p> <p>Sipas RVB, UT ka realizuar aktivitetin “Java e Europës në Universitetin e Tiranës”, të përmendur dhe në kriteret më sipër. Aktiviteti me temë “Shqipëria dhe Bashkimi European mbështesin të rinjtë nëpërmjet universitetit” është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme si dhe me delegacionin e Bashkimit European në Shqipëri. Nëpërmjet këtij aktiviteti UT synon të përfshijë studentët në periudha shkëmbimi në univesitetet partnere të BE duke ndihmuar formimin e tyre dhe aftësimin më tej në tregun e punës si dhe fitimin e eksperiencave në funksion edhe të përmisimit të programeve mësimore.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>






Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sipas RVB, në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT/FSHN i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit. Në këtë kontekst UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike në linkun https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/ . Sipas RVB, UT/FSHN publikon nëpërmjet postimit në faqen elektronike zyrtare të fakultetit/universitetit, Analizën e Pyetësorëve (dokumenti nr 6.10 mbi vlerësimin e lëndëve dhe dokumenti nr 6.15 mbi pyetësorin e vlerësimin të mësimdhënies online, Statutin e UT (dokumenti nr 1.2), Rregulloren e UT (dokumenti nr. 1.8, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj. si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Bazë duke krijuar kështu një imstitution të hapur për të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij. Në këtë mënyrë ofrohet një transparencë e plotë për të gjitha vendimet dhe aktivitetet në UT.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Sipas RVB, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, janë përpiluar raportet e analizës të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies (dokumenti nr. 6.10-6.15). Në këto pyetësorë dhe raporte përmbledhëse të tyre gjen të dhëna mbi vlerësimin që realizojnë studentët gjatë dhe pas diplomimit, vetëvlerësime të stafit akademik për lëndët që ofrojnë etj. Informacioni i publikuar në raporte respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas RVB, rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Për këtë qëllim DKI/FSHN, ka hartuar planin e masave për të gjithë tipet e pyetësorët të realizuar dhe ka adresuar dobësitë apo mangësitë e evidentuara në raportet analitike. Në shkresën me nr prot 1891/2 dt 31.01.2022, një nga pikat e nxjerra nga pyetësori i zhvilluar është dhe ndryshime në dy syllabuse, të cilat do të diskutohen në Departament për të marrë aprovimin e kërkuar.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas RVB, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë të programeve të studimit është një prej objektivave të Universitetit të Tiranës, e përcaktuar dhe në dokumentin nr 1.3, Strategjia e zhvillimit të UT. Në Planin e Masave (dokumenti nr. 6.8 dhe 6.9) për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, Departamenti i Kimisë Industriale parashikon shtimin e paisjeve të reja laboratorike, forcimin i lidhjeve me biznesin dhe industrinë për studentët që dëshirojnë të zhvillojnë praktikën profesionale, rishikimin e orëve laboratorike për

	lëndët me karakter praktik, shtimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare. etj. Nëpërmjet këtij plani Departamenti i Kimisë Industriale siguron efektivitet për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Sipas RVB, FSHN/ DSBCK organizon aktivitete dhe leksione informuese, si ai në dokumentin nr 5.17 , leksion i hapur për Keshillim Karriere, me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program i studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” ofrohet si program unik në një nga Fakultetet më me eksperiencë në këtë fushë.
2. Programi ka një kurrikul të stabilizuar që ofron njohuri të disiplinave në shkencat themelore dhe të aplikuar të kimisë, të teknologjisë ushqimore, mikrobiologjisë e bioteknologjisë së fermentimeve; dhe proceseve inxhinerike në industrinë ushqimore.
3. FSHN/ DKI ka laboratore të mirëpajisur në nivel didaktik dhe kërkimor në fushën e kimisë dhe teknologjisë ushqimore.

Pika të dobta:

1. Program Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” nuk e ka pjesë të kurrikulës praktikën profesionale. Kjo pikë duhet të konsiderohet sa më parë. (**Standardi I.5, Kriteri 4**).
2. Numër i kufizuar (vetëm katër) i kompjuterave me akses në internet në bibliotekë. Do të ishte e nevojshme që për një numër të madh studentësh të cilët janë pjesë e FSHN dhe e DK, të vendoseshin në dispozicion një numër më i madh pajisjesh kompjuterike ku ato të aksesojnë materialet online (**Standardi IV.4, Kriteri 4**).

Rekomandime:

1. Rishikimi i kurrikulës në mënyrë që të futen praktikat profesionale në programin e studimit Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”.
2. Rishikimi i ngarkesave të personelit akademik për të ulur peshën e tyre në mënyrë që të kenë mundësi ingranimit të stafit të ri (sidomos në seminare) dhe t’ju krijohet mundësia profesorëve për punë kërkimore – shkencore.
3. Politika nxitëse për pjesëmarrje në projekte kërkimore.
4. Krijimi i mundësive për stafin e ri (doktorantëve) për të punuar në laboratore kërkimore të huaja, në mënyrë që të kualifikohen dhe të kryejnë një pjesë të kërkimit të tyre jashtë vendit.

Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Food Chemistry and Technology" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"

Strengths and Affirmations:



1. The Bachelor study program in "Food Chemistry and Technology" is offered as a unique program in one of the most experienced Faculties in this field.
2. The program has a stabilized curriculum that provides knowledge of disciplines in the basic and applied sciences of chemistry, food technology, microbiology and fermentation biotechnology; and engineering processes in the food industry.
3. The Faculty of Natural Sciences/ Department of Industrial Chemistry has well-equipped laboratories at the didactic and research level in the field of chemistry and food technology.

Weak points:

1. Study Program Bachelor "Chemistry and Food Technology" does not include Professional Practice as part of the curriculum. This point should be considered as early. (**Standard I.5, Criterion 4**).
2. Limited number (only four) of computers with Internet access in the library. It would be necessary to install a larger number of computer devices where students could easily access online materials (appropriate for a large number of students who are part of the Faculty of Natural Sciences and Department of Industrial Chemistry) (**Standard IV.4, Criterion 4**).

Recommendations:

1. Revision of the curriculum in order to introduce professional practices in this Bachelor study program.
2. Reviewing the academic staff's workload to reduce their weight so that they have the opportunity to hire new staff (especially in seminars) and create opportunities for professors for research-scientific work.
3. Incentive policy for participation in research projects.
4. Creating opportunities for young staff (doctoral students) to work in foreign research laboratories, in order to qualify and carry out part of their research abroad.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përmbushjes	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

